



Albanian Platform for Policy Advocacy

Ekipi

BULETIN MARS 2016

Adela DANAJ
Blerina LLALLA
Brenton KOTORRI
Elena PICI
Endrit KAPAJ
Ergisa BEJKOLLARI
Flutura GJANA
Gerion TRESKA
Marcela TRINGAJ
Megi LLUBANI
Mimi BARUSHI
Mirilda TILI
Rezarta CAUSHAJ
Rigels XHEMOLLARI

*Faktet, analizat dhe qëndrimet e publikuara nga APPA,
nuk shprehin opinionin e partnerëve tanë.

KRYEMINISTRIA

Mirilda TILI, BA

1- Kryeministri dekriminalizues

Në muajin mars kryeministria u angazhua tërësisht në çështjen e dekriminalizimit të parlamentit, pas kërkesave të vazhdueshme dhe për një kohë të gjatë të opozitës dhe përfaqësive diplomatike të akredituara në Tiranë. Edhe pse Ndërsa opozita u përqendrua në krijimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, për të cilën si dhe për çështjen e lënies së mandateve ka ende debate të ashpra, mazhoranca dha shenja të vullnetit për t'u marrë me to dhe për të ofruar opsionet e veta. Në faqen online të qeverisë është publikuar në fund të muajit vendimi i Këshillit të Ministrave " Për garantimin e integritetit të personave, që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"¹, me qëllim realizimin në praktikë të ligjit numër 138/2015. Bashkëngjitur këtij vendimi është edhe formulari i vetëdeklarimit për këdo, që hyn në garë për të zënë vend në administratën shtetërore dhe për të ushtruar funksione publike. Vendimi nuk ka fuqi prapavepruese, çka do të thotë se formulari, i hartuar e i bërë publik tashmë, nuk u adresohet drejtuesve aktualë, por vetëm atyre që do të aplikojnë për në të ardhmen. Konkretisht, plotësimi i tij do të jetë i detyrueshëm për individët që pretendojnë të përfshihen në listat e deputetëve për zgjedhjet e ardhshme apo që do të emërohen në poste të ndryshme. Sipas ligjit, organet e përfshira në procesin e verifikimit duhet të ndjekin parimet e: a) ligjshmërisë dhe të procesit të rregullt ligjor; b) të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; c) të objektivitetit, profesionalizimit dhe eficiencës; ç) të transparencës dhe rritjes së besimit të publikut në organet shtetërore; d) të pavarësisë dhe paanshmërisë.

¹Për Garantimin e Integritetit të Personave që Zgjidhen , Emërohen ose Ushtrjnë Funksione Publike. Formulari i publikuar në faqen zyrtare të Kryeministrit.

<http://www.kryeministria.al/al/newsroom/udhezime/per-garantimin-e-integritetit-te-personave-ge-zgjidhen-emerohen-ose-ushtrone-funksione-publike-formulari>

Përmbajtja e formularit është cilësuar nga kryeministri i vendit, Edi Rama, si qesharak. "Por një gjë është e qartë, ata ikin sepse në këtë parlament dhe në anën e majtë të këtij parlamenti nuk ka asnjë person me rekorde kriminale. Ata ikin sepse ligji më ekstrem, unikal në planet i kaluar edhe me bekimin tonë për të ashtuquajturin dekriminalizim të parlamentit dhe të politikës, nuk arrin dot të zbulojë asgjë. Edhe gjithë ajo seancë absurde, 48 orë marrëzi, negociata të mbyllura 6 herë dhe të rihapura 6 herë për ta çuar në ekstrem një formular qesharak, ishte shprehja e dëshpërimit për faktin se ata 19 kriminelët që do kapeshin nga ky proces ishin vetëm pjellë e fantazisë së një propagande të shturur që prodhon çdo ditë fakte të rreme..."²

2- Po çfarë përmban formulari i kaq shumë debatuar?!

Asnjë gjë më shumë, apo më pak se detyrimi ligjor i plotësimit të një CV-je normale. 8 pyetjet shitesë kanë të bëjnë me një detyrim ligjor tjetër në aplikimin për një vend pune, pra dorëzimin e dëshmisë së penaltetit. Edhe pse pritej shumë më shumë gjatë këtij muaji, që vetë Reforma në Drejtësi të merrte udhë, sërish hartimi i këtij formulari shënjon një "arritje". Procesi i verifikimit është parashikuar të realizohet para kandidimit dhe votimit, sikurse edhe para emërimit në funksione publike me qëllim që të sigurohen të dhënat e nevojshme për çdo kandidaturë pretenduese dhe për të realizuar gjithashtu një administrim të procesit zgjedhor konform ligjit.

3- Pronat

Gjatë marsit ka filluar nga puna Agjencia e re e Trajtimit të Pronës. Zgjidhja e këtij problemi madhor është një ndërmarrje e rëndësishme për jetë politike e ekonomike në vend. Por a ishte e nevojshme një agjenci e re, apo do të mjaftonte vetëm vullneti i mirë dhe agjencitë ekzistuese për të gjetur me kohë zgjedhjet e duhura. Megjithatë është pranuar edhe nga ana e Kryeministrit se ka filluar lëvrimi me përparësi i 24 milionë

²Një pjesë e fjalimit të kryeministrit Rama, shkëputur nga ai i mbajtur në seancën parlamentare të datës 8 mars 2016.

<http://www.kryeministria.al/al/newsroom/lajme/opozit-e-pa-fakte-vetem-baltosje-arritjeve-te-qeverise1458723275&page=1>

dollarëve të parë, - shumë e pakrahasueshme me buxhetin e viteve të shkuara - si fond për kompensimin e pronave. Në të dhënat kryeministore thuhet se: "26 mijë vendime, të dhëna ndër vite të tëra me radhë nga Agjencia e Kompensimit të Pronave dhe të bëra kapicë në labirintin e padrejtësive e të korrupsionit me pronën, do të vlerësohen me një çmim. 23 mijë hektarë tokë bujqësore është në dispozicion si fond kompensimi fizik për të gjithë ata pronarë, toka e të cilëve është e zënë. 11 mijë qytetarë të Republikës së Shqipërisë që kanë aplikuar dhe janë zvarritur ndër vite për pronën e tyre, nga nesër do të kenë informacion publik në faqen zyrtare online të Agjencisë së re të Trajtimit të Pronës. Për të gjithë ata të cilët për një arsye a një tjetër, nuk kanë pasur mundësi të aplikojnë për pronën e tyre, është krijuar një mundësi e re: Një kërkesë me vetëm dy letra. Dy letra nga 30 që kërkoheshin deri më sot! Një dokument origjine dhe një hartë e pretenduar se ku gjendet prona. Në momentin që paraqiten këto dy letra dhe një kërkesë në Agjencinë e Trajtimit të Pronës, është barra e kësaj agjencie të verifikojë gjithçka duhet"- thuhet nga ana e kryeministrit. Por në të gjithë këtë "zgjidhje" të problemit nuk është folur për hartën e çmimeve për shpronësim, dhe madje nuk është përmendur në asnjë moment se çfarë do të bëhet me çmimet shumë qesharake të shpronësimit, ku një metër katror është shpronësuar me 200 lekë.

4- Kur guximi kapërcen kufijtë e arrogancës.

Përtej të gjithave komunikimeve publike dhe një pune shumë të mirë të zyrës së marrëdhënieve me publikun nuk mund ta lëmë jashtë vëmendjes intervistën që kryeministri Rama ka dhënë për Wall Street. Në përgjigjet e dhëna prej tij lexohet lehtësisht arroganca dhe mungesa e profesionalizmit. Më poshtë do të jenë disa nga përgjigjet dhe më pas gjithsekush mund të bëjë vlerësimet e veta. "Shqipëria nuk i hap kufijtë dhe nuk ngre mure. Ne thjesht duam një zgjidhje evropiane.

Ne nuk mund të ndihmojnë askënd vetëm, sepse ne nuk kemi mjetet për të ofruar ndihmë për të gjithë. Nëse Europa ka një plan, ne do të jemi pjesë e saj dhe ne do të bëjmë çfarëdo që do të na kërkohet.

Mënyra se si Europa e ka përballuar, deri tani, krizën [e emigrantëve] është një rrëmuje. Ky është një tjetër shembull se Europa ka nevojë për të ndryshuar.

Europa ka provuar se është e paaftë për të bërë një punë shumë themelore, ndërtimin e një shërbimi të përbashkët të inteligjencës. Djali, i cili u arrestua kohët e fundit [në Bruksel] dhe orkestroi masakrën në Paris, ka qenë në lëvizje nga një vend në tjetrin. Kjo do të thotë se nevoja për inteligjencën e përbashkët është shumë urgjente...³

A do të konsiderohet kjo lajthitja e radhës apo do të përkthehet si "guxim" për t'i ulur hundën Europës plakë?! Në të gjitha rastet, edhe për këtë muaj monitorimi të qashtë, kryeministria ka kryer një punë PR shumë të mirë, por niveli i transparencës me të cilat është shoqëruar zhvillimi ekonomik, politik dhe diplomatik i vendit, sërish lë shumë për të dëshiruar.⁴ Përtej aktiviteti kryeministror, axhenda ka qenë e ngarkuar me anëtarësimet e reja në Partinë Socialiste si edhe me zhvillimet e kongresit të kësaj partie.

³Takimi dhe biseda e z. Rama me Federica Mogherinin, Përfaqësuesen e Lartë të BE në Punët e Jashtme dhe Politikat e Sigurisë.

<http://www.kryeministria.al/al/multimedia/video-galeri/mogherini-ju-po-beni-gjera-te-medha-suksesi-juaj-eshte-sukses-per-europen>

⁴Ky raport mat varfërinë bazuar në paritetin e fuqisë blerëse- një nga dy metodat më të përdorura për të përcaktuar varfërinë në një vend.

<http://exit.al/2016/03/25/global-finance-shqipëria-nder-vendet-me-te-varfera-ne-europe/>

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTEVE

Rigels XHEMOLLARI, MSc

1- Zgjedhjet në universitete, reflektim i mentalitetit politik!

MAS miratoi në datën 15 mars 2016 rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe Urdhrin Nr. 110 "Për fillimin e procesit zgjedhor dhe datën 20 Prill, për zhvillimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë"⁵.

E parë në planin e institucioneve akademike, këto zgjedhje nuk pritet të sjellin ndryshime për sa i takon mentalitetit të sjelljes së rivalëve, të cilët kanë filluar të përdorin të gjitha mjetet dhe format që përdorën rivalët politike në zgjedhjet lokale dhe qendrore duke u konsideruar armiq dhe jo bashkëgarues. Pasojë e ligjit të ri për arsimin e lartë është dhe lënia në hije e studentëve, të cilët kanë 10% të peshës së vendimmarrjes në këto votime dhe janë më pak të rëndësishëm se sekretaret.

Sa i takon rolit rregullator dhe mbikëqyrës të procesit, Ministria e Arsimit dhe e Sportit nuk i kushtoi rëndësi këtyre zgjedhjeve jo vetëm duke nxjerrë në minutën e fundit rregulloren, por edhe duke e kaluar ngjarjen në mungesë të plotë vëmendjeje. Procesi do t'i jepej një dimension publik nëse KQZ do ta administronte procesin zgjedhor, si i vetmi institucion shtetëror që punon me zgjedhjet në Shqipëri.

Gjithashtu, duke iu referuar modeleve perëndimore, fushatat e kandidatëve mund të pasqyroheshin në një faqe online të ministrisë për të mundësuar përplasjen e ideve, të programeve dhe inkurajimin e debateve pozitive.

2 - Testohen mësuesit, të parët në dhunë, të fundit në dije.

⁵<http://www.arsimi.gov.al/al/newsroom/njofitime/rregullore-per-organizimin-e-zgjedhjeve-te-para-per-autoritetet-dhe-organet-drejtuese-ne-institucionet-publike-te-arsimit-te-larte-ne-republiken-e-shqiperise>

Në kuadër të reformës në arsimin parauniversitar, MAS publikoi Raportin Kombëtar të Identifikimit të Nevojave për Trajnimin e Mësuesve dhe të Drejtuesve⁶.

Ky raport nxori në pah shifra të errëta për sa i takon formimit të mësuesve, ku veçojmë:

- 42% e mësuesve i shpjegojnë vetvetes pasi kanë probleme në testin "Mësimdhënia dhe të nxënët"
- 52% e mësuesve çalojnë në etikë dhe komunikim me nxënësit dhe prindërit.

Duke iu referuar shifrave të mësipërme në rang republike, shkolla ka humbur dy qëllimet e saj kryesore që janë edukimi dhe mësimdhënia.

Jo më kot rasti i dhunës ku mësuesja rrihte nxënësit u shfaq në Dibër, pasi ky është edhe qyteti, ku mësuesit kanë dalë më dobët në testin e etikës dhe komunikimit. ⁷I ngjashëm ishte edhe rasti i Fierit, ku nëndrejtoresha kapi për flokësh drejtoreshën në sy të nxënësve.⁸

Ministrja e Arsimit znj. Nikolla këtë herë, ndryshe nga testimi i nxënësve, i kërkoi falje prindërve të 500.000 nxënësve si dhe pezulloi 51 agjencitë, të cilat pajisnin deri më tani me kredite mësuesit. ⁹

Gjithsesi nuk mjafton vetëm kaq për të luftuar dukurinë në fjalë, por nevojitet përmirësim i procesit të rekrutimit të mësuesve, i trajnimit dhe certifikimit të tyre dhe mbajtja larg kthetrave të përfaqësuesve politikë, pasi sistemi arsimor nuk mund të jetë tortë elektorale. Sa u përket rasteve të dhunës të shfaqura në shkolla muajin e fundit, duhet rritur prania dhe roli i bashkëpunimit me psikologun, i cili parashihet të mbulojë 3 shkolla dhe një shkollë ka minimalisht 1500 nxënës, si dhe

⁶<http://www.izha.edu.al/wp-content/uploads/2016/03/Raporti-IDENTIFIKIMI-I-NEVOJAVE-PER-TRAJNIM.pdf>

⁷<http://www.shekulli.com.al/p.php?id=406780>

⁸<http://www.gazeta-shqip.com/lajme/2016/03/11/nendrejtoresha-kap-per-flokesh-drejtoreshen/>

⁹http://www.gazetaexpress.com/lajme/nikolla-pezellon-51-agjenci-private-kreditimi-mesuesit-nuk-shkonin-fare-ne-trajnim-180762/?utm_source=website&utm_medium=RA&utm_content=Linda%20Nikolla,Mesues,Agjenci%20kreditesh&utm_campaign=InsideArticle&past_aid=

roli i policimit në shkolla, pasi prezenca dhe njoftimi i uniformave që mbulojnë territorin e shkollës mund të ndihmojë në mënyrë efikase në zbulimin dhe parandalimin e rasteve të njëpasnjëshme të dhunës.

3- Ministrja e Arsimit harron Sportin!

Nga muaji nëntor 2015 Ministrja e Arsimit znj. Nikolla nuk ka marrë pjesë në asnjë aktivitet sportiv. Ajo nuk ka promovuar dhe nuk ka folur publikisht për sportin që nga data 3 nëntor.¹⁰

Znj. Nikolla dhe institucioni që drejton është njëlloj përgjegjës për të dyja fushat që mbulon, fusha të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën. Në misionin e saj kjo ministri duhet të promovojë Federatën e Sportit shkollor dhe universitar, projektet që lidhen me edukimin sportiv në shkolla dhe kulturën e sportit në institucionet e edukimit.

¹⁰<http://www.arsimi.gov.al/al/newsroom/lajme/te-shendetshem-me-sport-te-ushqyer-me-art&page=4>

MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

Marcela TRINGAJ, L.L.M

1- Fondi SARED, një lajm i mirë për agrofincancimin

Paratë nuk mund të blejnë lumturinë, por mund të blejnë traktorë dhe kjo për fermerët pothuajse është e njëjta gjë. Bujqësia punëson 50% të fuqisë punëtore, por përfiton vetëm 4% nga totali i financimeve ndërsa kontribuon në vetëm 18% të PBB¹¹, shumë herë më pak se potenciali i saj real. Financimi i saj i vazhdueshëm është thelbësor për të përmirësuar rezultatet dhe konkurrueshmërinë në sferën e produkteve bujqësore primare, veçanërisht në zonat rurale. Investimet në teknologji, në stabilimente agro-përpunuese dhe në marketingun e produkteve bujqësore kërkojnë shuma të konsiderueshme parash.

Duket se lajme të mira vijnë nga MBZHUA. Programi gjermano-danez "Mbështetje për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural në zonat e pa favorizuara në Shqipëri" – SARED, zbatuar nga GIZ, garanton një fond prej 6.500.000 Euro për fermerët shqiptarë. Për investimet në nivel ferme, shuma totale e investimeve që duhet të aplikohet është nga 400.000 lekë deri në 3.500.000 lekë. Granti mbulon 75% të investimit. Për investimet jashtë ferme (për grumbulluesit dhe agro-përpunuesit) shuma totale e investimeve që duhet të aplikohet është nga 700.000 Lekë deri në 10.000.000 Lekë, dhe këtu granti mbulon sërish 75% të investimit.

Afati i aplikimit është nga 14 marsi deri më 30 qershor 2016 dhe përfshin fermerët e agropërpunuesit në gjashtë qarqe: Shkodër, Kukës, Dibër, Korçë, Elbasan dhe Berat. Mbështetja e skemës së grantit SARED do të ofrohet vetëm në tre drejtime kryesore: mbarëshkrimi i blegtorisë së imët (për prodhimin e qumështit dhe të mishit), pemët frutore dhe arrorët, bimët aromatike dhe mjekësore. Në vitin 2015, nga ky grant

¹¹AgroKapital një program për mbështetjen e financimit të agrobiznesit
<http://cbs.al/index.php?id=19>

përfituan vetëm 21 fermerë. Vlera totale e shpërndare ishte diku tek 277.218 Euro, rreth 4.3 % e fondit total prej 6.500.000 Euro, që pritet të lëvrohet deri në vitin 2018. Duket se fushata sensibilizuese drejtuar fermerëve në të gjithë vendin, që të aplikojnë për të përfituar nga fondi SARED në mbështetje të zhvillimit rural, ishte veç një faktor që ndikoi në realizimin në nivele tepër të ulëta të ofertës financiare tek fermerët në vitin 2015¹².

Detyrimi për të informuar dhe mbështetur fermerët dhe agropërpunuesit në aplikimin e tyre, duket se nuk është prioritet për MBZHUAU. Nëse tenton të telefonosh në numrin zyrtar të kësaj ministrie dhe konkretisht të koordinitorit për të drejtën e informimit, do të kesh mundësinë vetëm të dëgjosh në sfond një muzikë klasike dhe më pas linja mbyllet. Dhe nëse përdor detajet e kontaktit të MBZHUAU, të përfshira në broshurat informuese të projektit SARED, mos prisni as këtu që dikush t'ju përgjigjet. Asnjë përgjigje me e-mail nuk të kthehet, gjithashtu. Por nëse tenton të kontaktosh GIZ Albania, zbatuesin e këtij programi, suporti dhe asistencë është maksimale. Dhe ky përbën një lajm të mirë për gjithë të interesuarit të cilët do të kenë lehtësi burokratike gjatë aplikimeve të tyre, falë GIZ Albania.

2- Nevojë për transparencë, informacion dhe mbështetje

Gjatë një takimi në përvjetorin e Projektit AgroKapital, projekt në mbështetje të financimit të fermerëve dhe agrobizneseve shqiptare financuar nga USAID, ambasadori i SHBA u shpreh se ka ende shumë biznese që kanë nevojë për më shumë akses në kapital që të rriten dhe se nevojiten reforma ligjore për ta bërë sektorin kredidhënës më transparent¹³. Transparenca dhe informacioni shpesh kthehen në pengesat kryesore që fermerët të ndihen pjesë e suksesit të projekteve të financimeve në vend.

Bujqësia shqiptare, përveçse iniciativave financiare të qeverisë dhe partnerëve të huaj, kërkon mbështetje të vazhdueshme zinxhir në nivel rajonal e atë qendror.

¹²Udhëzuesi për Aplikantët

http://www.bujqesia.gov.al/files/pages_files/15-04-17-09-37-19Udhezuesi_per_Aplikantet.pdf

¹³ Lajme të Mira për Agrofinancimin

<http://agroweb.org/?id=10&l=906&ln=sq&url=lajme-te-mira-per-agrofinancimin>

Aplikimi i teknologjive bashkëkohore, nisma e studimeve të mirëfillta shkencore janë ende sfida që duhet të kthehen në domosdoshmëri. Strukturat këshilluese dhe informuese të institucioneve përgjegjëse thuhet nuk ekzistojnë, çka rezulton në një ngurtësim të marrëdhënieve direkte me fermerët. Sektori financiar bankar shpesh e sheh me risk dhënien e kredive për sektorin bujqësor. Ndërkohë është e domosdoshme që qeveria të sigurojë një fond garant për bankat. Ky financim pritët të premtohet nga qeveria.

Tashmë, pas 25 vitesh që nga fillimi i viteve '90, gjithkush e njih burokracinë zvarritëse të institucioneve publike dhe vështirësinë për të marrë informacione dhe të asistohesh nga punonjës të shërbimit publik, që paguhen prej taksave të qytetarëve. Në një epokë ku dixhitalizimi, teknologjia e avancuar, informacioni i shpejtë janë kthyer në kryefjalën e ditës, zonat rurale dhe ato malore përcjellin një realitet mesjetar. Fakti që infrastruktura ekzistuese minon lulëzimin e agrobizneseve, të bën të kuptosh se sektori që punëson gjysmën e shqiptarëve ka ende rrugë të gjatë deri në transformimin e tij të plotë e rrënjësor si kontribuues vital i ekonomisë shqiptare.

3- Me sytë nga qielli

Ndonëse e begatuar me pasuri të shumta, në Shqipëri pasojat e fatkeqësive natyrore thellohen për shkak të ndërtimeve pa kriter në zona të palejueshme, degradimit të pyjeve, shfrytëzimit të tokës dhe të pasurive natyrore që parandalojnë erozionin e tokës si dhe dëmtimit masiv të sistemit të kullimit të tokave, që ka sjellë një situatë përmbytjesh të përvitshme. Me një rrjet hidrografik me gjatësi 49.027 km dhe me një sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës 43.306 km⁴, do duhej të ishim krenar për pasurinë tonë natyrore. Por vepra e shëmtuar e shkatërrimit të rrjetit ujitës dhe kullues ka sjellë mospërdorimin në mënyrë eficiente të këtij burimi të vlefshëm, duke shkaktuar përmbytjet e rajoneve të tëra bujqësore si në jug ashtu dhe në veri. Është fakt ironik, që në zonat rurale udhëtohet larg për të siguruar ujin e pijshëm apo për kullim dhe transporti detyrimisht kryhet me kafshë shtëpiake.

Drejtoria e Emergjencave Civile, në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare, llogarit një kosto prej 35

milionë eurosh në vit që i krijohet vendit nga fatkeqësitë natyrore pa llogaritur kostot sociale¹⁴. Hartimi dhe miratimi i një ligji, nëpërmjet të cilit të bëhet sigurimi i detyrueshëm për fatkeqësitë natyrore, duhet të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë. Krijimi i një fondi të posaçëm si një e ardhur për kompanitë e siguracioneve, mund të jetë një rrugëzgjdhje për kompensimin në kohë reale të dëmeve që krijohen nga përmbytjet¹⁵.

E listuar nga Banka Botërore si një nga vendet më të rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore, Shqipëria ende nuk ka një platformë kombëtare të mbrojtjes nga ndryshimet e klimës apo katastrofat natyrore. Ky realitet vjen më i hidhur, pas zhgënjimit se investime serioze nuk janë kryer për parandalimin e fatkeqësive natyrore të përvitshme. Disa investime të pakta e në prag fushatash elektorale nuk janë vepra të mirëfillta dhe të qëndrueshme për të shmangur përmbytjet dhe për të zhvilluar bujqësinë shqiptare. Ajo çka përbën lajm të mirë është fillimi i projektit të kullimit gjatë këtij viti me fondin prej 25 miliardë lekësh, që pritët të konsolidohet në vitet që vijnë deri në plotësimin tërësor të rrjetit. Duke shpresuar në përfundimin e projektit, le të lutemi dhe të shpresojmë, duke mbajtur sytë nga qielli, për mëshirë!

¹⁴"PASURITË NATYRORE"
http://l.facebook.com/l.php?u=http%3A%2F%2Fwww.akti.gov.al%2Fdoc_03_05%2FFPKKZH_PasuriteNatyrore_2003_2005.pdf&h=RAQFh1n5NAQHGiXMuGdf5MIJ752SzpHhfkA5t0aG4PIylhA

¹⁵Fatura e përmbytjeve: 35 milion euro humbje çdo vit
<http://www.mapo.al/2016/01/fatura-e-permbytjeve-35-milion-euro-humbje-cdo-vit>

MINISTRIA E DREJTËSISË

Endrit KAPAJ, L.L.M

1- Pronat: qeveria detyrohet nga Gjykata e Strasburgut të nisë kompensimin e ish pronarëve

E detyruar nga vendimet e Gjykatës së Strasburgut, qeveria ka miratuar aktet nënligjore për kompensimin fizik dhe financiar të ish pronarëve. Në vitin 2006 Gjykata e Strasburgut nxori vendimin e parë në lidhje me zbatimin e ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës. Me gjithë kundërshtitë e forta nga shoqatat e ish pronarëve, Këshilli i Ministrave ka përcaktuar tashmë modalitetet për kompensimin e pronave dhe vendimmarrjen në lidhje me dosjet e pashqyrtuara.¹⁶

Prej 22 vitesh shteti ynë ka marrë përsipër detyrimin për të riparuar atë që ka qenë një shpronësim i padrejtë në vitin 1945, duke nxjerrë vendime administrative dhe gjyqësore që njohin të drejtën e pronës, prandaj dhe vetëm për këtë arsye, sot mbi shtetin dhe shoqërinë shqiptare rëndon barra e ekzekutimit të këtyre vendimeve. Ajo çka kundërshtohet është vlerësimi i shtetit shqiptar për të përcaktuar mënyrën e ekzekutimit të këtyre vendimeve duke anuar nga interesi financiar publik sesa nga ai privat.

Pikërisht për këtë arsye ligji është dërguar në Gjykatën Kushtetuese për të verifikuar kushtetutshmërinë e kësaj formule. Por kjo nuk e pengoi Z. Manjani, i cili në cilësinë e Ministrit të Drejtësisë t'i bënte "thirrje" kësaj gjykate për të mos e shpallur antikushtetues pikërisht këtë pjesë të ligjit. Thirrja e Ministrit të Drejtësisë, pavarësisht si shprehje e një pale të interesuar, e dalë nga një përfaqësues i ekzekutivit cenon hapur parimin e ndarjes së pushteteve dhe aq më keq është një presion verbal ndaj pushtetit gjyqësor.

2- Ekzekutivi "leh", por karvani i korrupsionit ecën përpara

¹⁶Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore <http://www.drejtesia.gov.al/al/newsroom/lajme/zbatimi-i-ligjit-te-trajtim-it-te-prones-qeveria-miraton-tre-vendime-te-rendesishme&page=1>

Ministri i Drejtësisë ka shfrytëzuar pjesëmarrjen në Konferencën Gjyqësore Kombëtare për të evidentuar konstatimin e tij se ka vënë re një prirje: nga gjyqtarët po punohet si për ditën e fundit. Ministri ka argumentuar se këtë e provon me vonesat në shpalljen e vendimeve në mënyrë të paarsyetuar, ose me vonesat në arsyetim - një sëmundje e vjetër kjo, që ka marrë përmasa më të mëdha nën klimën e papërgjegjshmërisë dhe duke "pritur Godonë", se diçka do të ndodhë me reformën, ndaj hajde t'i biem në top...¹⁷ A thua vallë se bëhet fjalë për kaçakë, të cilëve tashmë u ka hyrë frika se shteti dhe ligji po vjen!

Së pari, nga ana e ekzekutivit konstatohet se ka një tendencë për fryrjen e efekteve të reformës në sistemin gjyqësor: herë - herë ajo shihet si shkopi magjik dhe në raste të tjera i jepet një trajtë objektive dhe materiale, e cila duke u shfaqur në derën e gjykatave do t'i largojë ata që janë të korrumpuar. Parë nga këndvështrimi i rritjes se besimit publik tek gjyqësori, kjo mund të japë efektin bumerang, për arsye se mungesa e efektit të menjëhershëm do të sillte, ashtu sikurse është provuar në historinë e shtetit shqiptar, humbjen e besimit tek kjo reformë.

Së dyti, institucionet duhet të zbatojnë kuadrin ligjor ekzistues për luftën ndaj korrupsionit, që padyshim nuk është më i miri, por është i mjaftueshëm për të luftuar rast pas rasti. Konkretisht, sot është në fuqi ligji për parandalimin e konfliktit të interesit. Ligji detyron institucionet të mbajnë regjistra të posaçëm për evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit në vendimmarrje nga nëpunës të administratës publike qendrore apo vendore. Nuk ka asnjë rast të vetëm që një institucion publik të ketë bërë transparente ekzistencën e konfliktit të interesit në vendimmarrjen e titullarëve të tyre. Sollëm rastin e këtij ligji të veçantë për të ilustruar se lufta ndaj korrupsionit është një ndërmarrje shumëplanëshe dhe në të cilin marrin pjesë në mënyrë aktive të gjithë aktorët. Jo më kot është fjala "Djali fshihet në detaje".

¹⁷Fjala e Ministrit gjatë konferencës <http://www.drejtesia.gov.al/al/newsroom/lajme/fjala-e-ministrit-te-drejtësisë-z-ylli-manjani-gjate-konferencës-gjyqësore-kombetare&page=1>

3- Të rejat nga Reforma në Drejtësi

Komisioni i Venecias publikoi më datë 14 mars opinion e saj final në lidhje me Amendamentet Kushtetuese. Opinionin në formën e saj zyrtare mund ta gjeni në linkun vijues

[http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2016\)009-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2016)009-e) .

Në përfundim të opinionit të saj, Komisioni i Venecias shpreh miratimin në lidhje me përputhshmërinë e amendamenteve të propozuara me standardet europiane dhe nxit palët ta kalojnë këtë paketë sa më shpejt në Parlament.

Por ashtu, sikurse me të drejtë Komisioni i Venecias konstaton, ky është vetëm fillimi i punës pasi miratimi i këtyre ndryshimeve kushtetuese kërkon hartimin dhe miratimin e një pakete të plotë ligjesh për të bërë të mundur funksionimin e të gjithë kuadrit ligjor dhe institucioneve kushtetuese të krijuara apo ndryshuara rishtazi.

MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIË

Ergisa BEJKOLLARI, BA

1- Të gjithë sytë mbi ARMO-n!

Këtë muaj të gjithë i kishin sytë mbi ARMO-n, kush e kush të përfitonte më shumë. Ky muaj ishte fatal për rafinerinë më të madhe në vend, që shkoi kaq pranë falimentit, por si pasojë e faktit që përbën sektor strategjik, asaj i ndalohej hapja e procedurave të falimentimit. Më poshtë do të diskutohen:

- a) Reagimi i menjëhershëm i kredithënësve, përkatësisht i bankave të nivelit të dytë: Raiffeisen, Tirana dhe i shtetit, që është edhe ortak me zotërim 15% të aseteve.
- b) Pasojat sociale.
- c) Opsionet e mundshme që mund të ndjekë qeveria, në kuadër të politikave publike, për të ndihmuar në rimëkëmbjen e kompanisë.

E para nga bankat e nivelit të 2-të, ishte Raiffeisen Bank, që nxori në ankand objektet në fshatin Drizë, ankand që dështoi dhe si rrjedhojë e të cilit në raundin e dytë trualli dhe ndërtesa do nxirren me gjysmë çmimi, pra nga 20 milionë në 10 milionë euro.¹⁸Dështimi i ankandit dhe mungesa e ofertave serioze tregon pikërisht zhvlerësimin që ka marrë kompania në sytë e investitorëve. Madje edhe interesi për përpunimin e bitumit nga ana e një kompanie zvicerane, humbi pikërisht për shkak të nivelit të lartë të borxheve!

Më pas të njëjtën gjë nxitoi të bënte dhe Tirana Bank me anë të një zyre private përmbartimore.¹⁹ Por, me sa duket i vetmi që ka përfituar deri më tani ka qenë shteti shqiptar, i cili është dhe ortak me 15% të aseteve në zotërim. Albpetrol ka fituar gjyqin ndaj kompanisë duke përfituar kështu 30

¹⁸Ankandi për shitjen e pjeseshme të kompanisë ARMO nga ana e shoqërisë përmbartimore EPSA për llogari të Raiffeisen Bank. <http://www.monitor.al/23-mars-ankandi-dyte-per-armo-n-vlera-zbret-nga-20-ne-10-milione-euro/>

¹⁹Përpjekja e Tirana Bank për sekuestro ndaj ARMO-s për vlerën e borxhit 2.8 milionë euro. <http://www.monitor.al/edhe-tirana-bank-sekuestron-armo-n-kreditorin-te-madh-te-keq-ne-shqiperi/>

milionë euro të mbledhura nga fatura të papaguara.²⁰

Për sa u përket pasojave sociale, nga të dyja rafineritë që zotëron ARMO, ajo e Ballshit nuk funksionon më, ndërsa e vetmja që mund të sjellë përfitime është rafineria e Fierit. Dhe ndërkohë që në gjykatë luftojnë të mëdhenjtë, nuk është menduar ende për ata që kanë mbetur të papunë apo për punonjësit, të cilët prej kohësh protestojnë për të marrë pagat e vonuara. Në kuadër të politikave publike, ashtu si dhe vetë ministri Gjijnuri ka thënë në një intervistë për televizionin News 24²¹, sfida e ministrisë është të gjejë një operator privat që do menaxhojë në mënyrë eficiente kompaninë. Gjë që na sjell dhe njëherë në pikën fillestare. Shumë mirë mund të aludojmë se arsyeja e kësaj gjendjeje të ARMO-s është padyshim keqmenaxhimi.

Opsion tjetër është dhe ndërhyrja e shtetit në lehtësimin e borxheve dhe detyrimeve të shumta, që nuk mund të shlyhen në afatshkurtër. Kështu që bazuar në nenin 15 të Kushtetutës "Ndihma shtetërore për ndërmarrjet në vështirësi", ligji thekson se shteti mund të ndihmojë ndërmarrjet në vështirësi për t'u ristrukturuar bazuar në plane konkrete. Me ndihmë kemi parasysh faljen e detyrimeve, përjashtim nga tatim – taksat për një periudhë të caktuar, injektim kapitali të freskët financiar, etj.

2- Borxhe, borxhe, borxhe!

Marsi ishte fatal jo vetëm për ARMO-n, por edhe për gjigandin turk "Kurum", që më 26 shkurt prezantoi deklarin e falimentit. Në këtë rast, falimentimi do të përdoret si një strategji ristrukturimi me qëllim final rimëkëmbjen. Kompania do të ketë një administrator të përkohshëm dhe do të kontrollohet nga debitorët.

Është për t'u habitur sesi një kompani, e cila deri në fund të vitit 2014 renditej si një nga 5 operatorët më fitimprurës në vend, shpall falimentin pas një viti e gjysmë. Edhe në rastin e Kurum, prapë problemi kryesor ishin borxhet. Sigurisht që situatën e ka rënduar

²⁰ 30 milionë euro për Albpetrol, me vendim për ekzekutim të menjëhershëm. <http://www.monitor.al/albpetrol-fiton-gjyqin-armo-n-per-30-mln-euro-borxhe-merr-edhe-te-ardhurat-nga-shitja-e-kolateraleve-te-bankave/>

²¹ Burimet natyrore përballë luhatjes së çmimeve, Të bësh ekonomi, 23 mars 2016. <https://youtube.com/ëatch?v=V-qL3mxJ2F4>

rënia e çmimit të hekurit, kriza e sektorit të ndërtimeve dhe pezullimi i lejeve për ndërtime, por ajo që i dha goditjen fatale është blerja e vitit 2013 që Kurum ka bërë për 4 HEC-e në vlerën 109.7 milionë euro. Tenderi i hapur nga ish-Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës u mbyll me ofertën e Kurum, që u kritikua asokohe për çmimin e ulët të ofruar²². E gjithë blerja u realizua me anë të kredisë prej 106 milionë eurosh në institucione brenda dhe jashtë vendit, çka e futi kompaninë në një vorbull borxhesh, detyrimesh dhe huash që shkaktuan dhe falimentimin. Në total Kurum, sipas bilancit, ka 300 milionë euro detyrime.²³

Së fundmi, për të dyja rastet vlen të thuhet se është e dukshme që të dyja janë pasojë e një keqadministrimi dhe anashkalimi apo mungese vëmendjeje nga ana e ministrisë. Gjithashtu është e çuditshme sesi nuk u parashikua falimentimi dhe sesi nuk po flitet për të. Ndoshta shitja e HEC-eve tek Kurum, pa marrë parasysh gjendjen financiare të saj, ishte një gabim nga ana e qeverisë së mëparshme, por nëse do t'i ishte kushtuar më shumë vëmendje nga ana e qeverisë aktuale, a do ishte shmangur deri në një farë mase falimentimi i Kurum-it?

3- Bankers Petroleum "ndërron faqe"!

Ashtu siç u konstatua dhe në raportin janar-shkurt 2016 të APPA-as për Ministrinë e Energjitikës dhe Industrisë²⁴, rënia e çmimit të naftës në tregun global shkaktoi pezullimin e aktivitetit të Bankers për 6 mujin e parë të vitit. Por mesa duket, Bankers ndërroi strategji, pasi në mars kompania njoftoi se ka vendosur të shesë veten te një kompani kineze me emrin "Geo-Jade Petroleum". Çmimi i shitjes është sa dyfishi i vlerës së "Bankers" në bursën e Torontos. Do na duhet të presim për të parë ndikimin ekonomik-social të "pronarëve të rinj", por ndërkohë mund të flasim për rinegocimin e kushteve të marrëveshjes që MEI ka bërë me Bankers.

²² Informacion i shkurtër i gazetës tema rreth tenderit të 4 HEC-eve, tender i fituar nga Kurum.

<http://www.gazetatema.net/web/2013/01/09/lajm-i-fundit-qeveria-vendos-kurum-blen-kater-hidrocentrale-per-109-5-milion-euro/>

²³ Listë e borxhlinjeve dhe arsytet e falimentit të Kurum.

<http://www.monitor.al/zbardhen-borxhlinjte-e-kurum-dhe-arsyet-e-falimentit/>

²⁴ Raporti janar-shkurt 2016 i APPA-s për MEI, ku midis të tjerave, evidentohen dhe pasojat e rënies së çmimit të naftës në kompanitë vendase të nxjerrjes dhe përpunimit. <http://appa.al/raport-janar-shkurt-2016-ministria-e-industrise-dhe-energjitikes/>

"Për herë të parë, po ju them se kemi vënë nivelin tavan të shpenzimeve. Do të thotë që shteti shqiptar fillon merr që në fuçinë e parë fitim nga nafta që i përket vendit tonë " ka shpjeguar ministri Gjijnuri për modelin e ri.

MINISTRIA E FINANCAVE

Elena PICI, BSc

Muaji mars gjeti në detyrë Ministrin e ri të Financave, z. Arben Ahmetaj²⁵, të cilit i urojmë suksese në detyrën e re, sidomos në një situatë ku stabiliteti makro-ekonomik është sfiduar nga problematika te reja, që do të trajtohen më poshtë në këtë raport.

1- Rreziku i deflacionit – çfarë duhet të marrim në konsideratë²⁶

Debati publik për financat gjatë muajit mars është përqendruar tek situata e rënies së çmimeve në vend, të cilën guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, e pranoi si një situatë dezinflacioniste, por theksoi se nuk jemi në deflacion (pra nuk kemi arritur në vlera negative). Pavarësisht termit, ne (sikurse shumë ekspertë të tjerë të ekonomisë²⁷) gjykojmë se kjo është një situatë për t'u mos anashkuar me argumentin se 'është e përkohshme dhe jo e rrezikshme'. Është e rëndësishme të trajtohen shkaqet dhe pasojat e deflacionit dhe masat që Banka e Shqipërisë duhet të marrë në bashkëpunim me qeverinë.

Në muajin shkurt inflacioni pësoi rënie më të madhe të 13 viteve të fundit në vlerën 0.2%. Banka e Shqipërisë e argumentoi situatën bazuar në faktorët e huaj që ndikojnë në ekonomi, si p.sh. rënia në nivel botëror e çmimit të naftës (rënie 8% në bursat europiane) apo rënia e çmimeve të mallrave të konsumit nga importi (që edhe në Shqipëri do të kishin rënë po mos të ishte për përmbytjet e fundvitit që rritën çmimet e fruta-perimeve²⁸). Sigurisht, që këta faktorë ndikojnë, pasi e gjithë zona ekonomike europiane po i druhet situatës deflacioniste²⁹. Megjithatë, situata nuk duket të jetë aspak e përkohshme dhe për këtë duhet kuptuar roli negativ që ka deflacioni.

²⁵Për më shumë, referojuni raportit të muajit Shkurt, APPA!

²⁶Institucioni kryesor përgjegjës për stabilitetin e çmimeve është Banka e Shqipërisë, por kjo temë po trajtohet në këtë raport pasi shkaqet dhe masat që duhen marrë janë ndër-institucionale

²⁷Angjeli, A. Mars 2016. <http://www.panorama.com.al/deflacion/>

²⁸Mapo.al. Mars 2016. <http://www.mapo.al/2016/03/te-dhenat-e-bsh-pa-permbytjet-do-kishim-deflacion-qe-ne-2015-n>

²⁹The Economist. Janar 2016.

<http://www.economist.com/blogs/economist-explains/2015/01/economist-explains-4>

Është e vështirë nga shumë të kuptohet se deflacioni, megjithëse nënkupton një ulje të çmimeve dhe një vlerësim të monedhës, është në fakt një situatë jo favorizuese për ekonominë. Përrjashtim bëjnë rastet kur ulja e çmimeve vjen si pasojë e rritjes së produktivitetit në prodhim, i cili mund të jetë rezultat i përdorimit të teknologjive të reja, pra çmimet ulen pa prekur të ardhurat për konsum. Ky nuk duket të jetë rasti i Shqipërisë (dhe as i Europës në fakt) ku situata dezinflacioniste është rezultat i tkurrjes së konsumit dhe i kapaciteteve të papërdorura në ekonomi, që nënkupton rritje ekonomike nën potencial.

Rënia e nivelit të inflacionit ka nisur që me vitin 2010. Periudha të gjata dezinflacioni shkaktojnë stagnim ekonomik dhe rritje të papunësisë, si pasojë e uljes së konsumit dhe rënies së normave të interesit, çka nuk favorizon depozitat bankare. Gjithashtu, rritja e vlerës së parasë rrit dhe vlerën e borxhit të huaj, që ndikon drejtpërdrejtë në buxhet. Në këtë situatë, në skenarin më të mirë të të cilit inflacioni do të shkojë 2%, duket shumë e vështirë që rritja ekonomike të jetë 3.4% sipas parashikimeve të fundit të FMN-së³⁰ pas takimeve 2 javore në Tiranë.

Në mënyrë që kjo të bëhet e realizueshme ne sugjerojmë që përtej politikave ekspansioniste te Bankën Qendrore (pra rritjes së ofertës së parasë), qeveria duhet të fokusohet tek riorganizimi ekonomik për të nxitur nivelet e punësueshmërisë dhe rikonsiderimi i sistemit të taksave. Ndonëse në 2016-n nuk pritet të ketë ndryshime të mëdha në taksat direkte – pas rritjes dy vjet radhazi të tatimitit, tatimit mbi të ardhurat personale, taksës së qarkullimit dhe akcizës së disa produkteve – bizneset do të përballen me kostot e taksave e tarifave indirekte³¹. Situata mund të ishte ndryshe sikur çmimi i naftës apo i energjisë elektrike të ulej (meqenëse ka dhe dezinflacion) për konsumatorët në Shqipëri po aq sa në Europë (në fakt në Shqipëri ka pësuar vetëm ngritje).

Së fundmi, duhet nxitur shtimi i të ardhurave. Me rënie e remitançave nga

³⁰Exit.al. Mars 2016. <http://exit.al/2016/03/22/konkluzionet-e-misionit-te-fmn-se-pikat-kryesore/>

³¹Për më shumë referojuni: Liperi, O. Revista Monitor. Janar 2016.

<http://www.monitor.al/taksat-e-fshehta-shumefishojne-barren-e-refiskale/>

emigrantët, burimi kryesor i të ardhurave për familjet janë pagat. Ngrirja e pagave për sektorin publik për 3 vjet nuk favorizon konsumin dhe ul standardin e jetesës. Kjo duhet shoqëruar dhe me politika punësimi, të cilat në të njëjtën kohë japin dhe shpresë për personat që vazhdojnë të emigrojnë, të cilët kanë pasur një farë ndikimi në uljen e konsumit dhe mosqarkullimin e parasë.

fatkeqësisht ndodh rëndom) dhe do të favorizonin rigjallërimin e ekonomisë.

2- Problemi i radhës? – realizimi i shpenzimet kapitale

Në një kohë që viti i kaluar u karakterizua nga mosarritje të vazhdueshme të planit për të ardhurat buxhetore, bilanci i treguesve paraprakë fiskalë për dy-mujorin e parë të vitit 2016³² (publikuar me vonesë nga Ministria e Financave) karakterizohet nga një situatë e anasjelltë. Mbledhja e të ardhurave për këtë periudhë ka realizuar plotësisht planin, madje për disa tatime të caktuara si p.sh. Tatimi mbi Fitimin janë realizuar mbi masën 100% (kjo ndoshta edhe për shkak të bazës së ulët të krahasimit³³ me vitin më parë). Problemi i radhës është në fakt mosrealizimi i shpenzimeve kapitale, ku bëjnë pjesë të gjithë investimet publike, të cilat ishin 2 herë më të ulëta se ato të një viti më parë. Për rrjedhojë, buxheti i shtetit përgjatë 2 mujorit të parë të vitit rezultoi me një suficit (tepricë) prej rreth 9.9 miliardë lekësh.

Pavarësisht se termi suficit mund të përngjajë pozitiv, kjo është një situatë në të cilën qeveria nuk mund të ketë luksin të mbajë para të pashpenzuara në buxhet³⁴. Kjo sepse shpenzimet korrekte (pra ato për paga, pensione dhe interesa borxhi) janë realizuar, ndërkohë që mosrealizimi qëndron tek shpenzimet për investime, të cilat janë ato që në fakt i japin shtysë zhvillimit ekonomik. Kjo situatë kërkon angazhimin e qeverisë për realizimin e investimeve publike, të cilat do të lehtësonin dezinflacionin (trajtuar në temën paraardhëse), do të shmangnin shpërdorimin e suficit buxhetor për projekte të nxituara gjatë muajve të fundit të vitit (skenar që

³²Ministria e Financave. Mars 2016.

<http://www.financa.gov.al/al/njoftime/lajme/treguesit-fiskale-paraprake-te-buxhetit-te-konsoliduar-per-2-mujorin&page=1>

³³Erebara, Gj. Mars 2016. <http://www.reporter.al/problemi-i-ri-i-qeverise-shpenzimi-i-pakte-i-parave-te-buxhetit/>

³⁴Tomorri, K. Mars 2016.

<https://www.facebook.com/klodian.tomorri?fref=ts>

MINISTRIA E INTEGRIMIT EUROPIAN

Rezarta CAUSHAJ, BA

1- Vleresimi jonë për Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020³⁵

Ministria e Integritimit ka publikuar këtë muaj draftin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim e Integrim 2015-2020 duke kërkuar që në harkun kohor prej 30 ditësh qytetarët apo grupet e interesit të dërgojnë kritikën apo propozimet e tyre për të përket këtij dokumenti. Më poshtë po sjellim propozimet e APPA's që do t'i dërgohen Ministrisë në mbyllje të muajit. Më saktë kemi hasur këto probleme gjatë shqyrtimit:

- a. në formulim, ku sjellim si shembull fjalinë "Dokumenti i SKZHI është i harmonizuar në pikëpamje të përmbajtjes dhe të periudhës kohore dhe të përmbajtjes me një sërë dokumentesh strategjike, të cilët janë hartuar në të njëjtën periudhë kohore me këtë dokument." Për të shmangur pështjellimin që krijon përsëritja e fjalëve, sugjerojmë një rishikim nga ky aspekt. Një rast tjetër është "Hapja dhe përfundimi me sukses i negociatave për procesin e integritimit evropian të Shqipërisë mbeten përparësia sinjalizuese për periudhën e zbatimit të SKZHI-II." Nuk është e qartë ajo që thuhet: a nënkupton kjo se SKZHI-II do të gjej zbatim pas hapjes zyrtare të negociatave apo pavarësisht a do të hapen apo jo negociatat?
- b. në përmendjen e dokumenteve që janë marr parasysh (dokumentet programuese të institucioneve, partnerëve apo raportet) kërkojmë që Ministria t'i bashkëngjis me shënimin përkatës në këndin e referencave
- c. në mungesën e referencave për sa i përket pohimeve si "Shqipëria u rendit në nivelin e lartë ndër vendet me të ardhura të mesme, sipas klasifikimit të Bankës

³⁵ Republika e Shqipërisë, Keshilli i Ministrave. Strategjia Kombëtare për Integrim dhe Zhvillim 2015-2020. Online: https://ssl.kryeministria.al/SKZHI_draft%20per%20konsultim_25.3.2016.pdf

Botërore." në mënyrë që të kuptohet cilës përuddhë kohore i përkon ky vlerësim.

- d. në mungesën e indikatorëve konkret kur i referohet sukseseve të arritura, duke shmangur përdorimin e fjalive me karakter deklarativ
- e. seksioni i Mësimeve të nxjerra pjesërisht është dhënë në terma të përgjithshëm, jo konkret dhe jo reflektues
- f. na duhet të kundërshtojmë me forcë se matja e progresit të integritimit/zhvillimit mund të bëhet sipas mënyrës së paraqitur në SKZHI-II ose më saktë thuhet se: "Arritja do të matet me anë të:
 - o Reformimit të administratës publike, institucioneve të qëndrueshme dhe një shërbimi civil modern, profesionist dhe të depolitizuar;
 - o Forcimit të pavarësisë, efikasitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të gjyqësorit; SKZHI-II 2015 - 2020
 - o Shtimit të luftës kundër korrupsionit;
 - o Shtimit të luftës kundër krimit të organizuar; dhe
 - o Sigurimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut (përfshi të drejtat e pronës)."Theksojmë se matja e arritjeve kërkon ngritjen e një sistemi të rregullt të raportimit të bazuar në indikator apo tregues konkret e të matshëm. Pra, në vetvete asnjë nga hapat e radhitura më sipër nuk siguron një matje të progresit, por nënkupton thjeshtë hapa, të cilat synojnë arritjen e integritimit/zhvillimit.
- g. vërejmë me keqardhje se i gjithë dokumenti është përpiluar duke u bazuar në një vendosje objektivash pa fund, të arritshëm dhe të paarritshëm, ka një mungesë caktimi prioritësh, ka një mungesë hierarkie në problemet më emergjente që përballen vendi jonë dhe nuk shoqërohet në asnjë rast me planin përkatës të punës se si do të realizohen objektivat, nuk ka ndarje në plane pune apo kush do t'i realizojë ato si dhe pasqyra përkatëse e faturës financiare.

Kolaudojmë se e gjithë strategjia duhet përpunuar nga e para, mundësisht të zhvishet nga trajtimi i brendshëm teorik dhe

propagandistik e të zëvendësohet nga një trajtim operacional. Duke marr parasysh disa prej dokumenteve strategjike të miratuara, mund të themi me bindje se shumica e tyre nuk janë marr në shqyrtim në përpilim.

2- Draft rezoluta për Shqipërinë pozitive?!

Gjatë këtij muaji Ministri i Integritimit, Znj. Gjoshka ka zhvilluar disa takime të nivelit të lartë në Bruksel, midis të cilave ato me komisionerin Hahn, eurodeputetin Pitella dhe raportuesin për Shqipërinë, Z. Fleckenstein. Natyrisht, objekti i vizitës s'mund të jetë veçse për t'i dhënë shtysë axhendës sonë kombëtare për hapjen e negociatave për anëtarësim në BE. Kjo vjen pasi raportuesi Z. Fleckenstein ka depozituar muajin e kaluar Draft rezolutën pranë Parlamentit Europian. Nëse do ndjekim raportimin e dobët në përmbajtje të Faqes Zyrtare të Ministrisë³⁶, takimet kanë qënë sukses dhe kanë pasur në sfond reformën në drejtësi dhe përparimin e bërë në plotësimin e 5 prioriteteve. Por duke iu referuar vetë dokumentit të Draft rezolutës³⁷, arrijmë të kuptojmë se situata nuk është nga më optimistet. Kjo është e kuptueshme nëse marrim parasysh gjithë amendamentet e propozuara për dokumentin në fjalë nga eurodeputët. Është e lehtë të kutosh në vija të përgjithshme se cili do të jetë drafti përfundimtar duke patur parasysh se ka patur propozime ndryshimi që nga detajet më të vogla, sic është pohimi në Draft rezolutë se vendi jonë "ka bërë progres të qëndrueshëm në reforma" duke propozur që të amendohet që ka bërë shumë pak, pak ose aspak progres.

Shqetësime të tjera janë shprehur nëpërmjet amendimeve si: a.reforma e thellë strukturore në drejtësi dhe ndryshime që duhet të prekin mënyrën se si trajtohen çështjet, kapacitetet investigative dhe qasja proaktive e agjensive investiguese e jo

³⁶Ministria e Integritimit. Ministria gjoshka vizite zyrtare ne Bruksel: Takime me Eurodeputetet Knut Fleckenstein dhe Gianni Pitella. Online:

<http://www.integrimi.gov.al/al/newsroom/lajme/ministria-gjoshka-vizite-zyrtare-ne-bruksel-takime-me-eurodeputetet-knut-fleckenstein-dhe-gianni-pitella&page=1>

³⁷

<http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubR ef=%2f%2fEP%2f%2fNONSGML%2bCOMPARL%2bPE576 .893%2b01%2bDOC%2bPDF%2bV0%2f%2fEN>

thjeshtë konsensusi partiak mbi reformën, marrjen parasysh të rekomandimeve të Komisionit të Venecias; b. problematikës së luftës kundër korrupsionit, ku propozohet të forcohet legjislacioni anti korrupsion, trupat e pavaruara investigative, të rritet trasparenca sidomos për prokurimet publike, të merret fushatë për informimin e publikut se korrupcioni gërryen financat publike dhe ndalon investimet, si dhe të bëhet më shumë në luftën ndaj narkotrafikut, por edhe trafikut të armëve në shumë vende europiane, kërkohet me forcë që autoritetet të vendosin para drejtësisë përgjegjësit e 21 janarit; c. për reformën elektorale kërkohet të theksohet fakti që zgjedhjet e fundit janë lejuar të kandidojnë persona me precedent penal apo të dënuar, kërkohet zbatimin e rekomandimeve të OSBE/ODIHR dhe që KQZ të përcaktojë përgjegjësitë e saj e të mos mbeshtetet vetëm në deklaratimet zyrtare të financimit të fushatave elektorale të partive, por të investigojë burimet deri në fund; d. kërkohet të implementohet Udhëzuesi për Shoqërinë Civile, të forcohet pjesëmarrja e minoriteteve në konsultime dhe t'u hiqet barra fiscale (TVSH) organizatave të shoqërisë civile; e. amendime që adresojnë projektet e shumta për ndërtimin e HEC-eve në zona të mbrojtura dhe ndërhyrjet në parqet kombëtare; h. Amendime që theksojnë mungesën e shtypit të lire, vetensurimin e gazetarëve, erë herë duke theksuar kërcenimet që u bëhet këtyre të fundit, nevojën për garantimin e shtypit të avarur, kritikon ngritjen e një padie ndaj BIRN për hetimin e kandidatëve me të kaluar kriminale në zgjedhjet lokale; g. amendime të shumta për shkeljet e të drejtave të njeriut, për trajtimin e pabarabartë gjinor, për mosgarantimin e zbatimit të ligjit etj. Ka patur edhe propozime që duke patur parasysh raportin mbi progresin e Shqipërisë t'i mohohej direkt hapja e negociatave apo që të ndalet përkohësisht procesi i zgjerimit deri në marrjen seriozisht të përbushjes së kriteve. Nëse i marrim propozimet për amendime tw mundshme si kritika, duke qënë se në tone ashtu paraqiten, gjasat janë që vendi jonë nuk përfiton asnjë hapje negociatash në të ardhmen e afërt.

MINISTRIA E KULTURËS

Blerina LLALLA, MA

1- Kultura e koncesionit dhe trashëgimia

Prirja e qeverisë dhe e politikave aktuale që ka shqetësuar shumëkënd në shoqërinë shqiptare, mbetet aksioni "koncesion", një kulturë politiko-ekonomike mbisunduese në vitet e fundit. Kësaj mode nuk mundi t'i shpëtonte as Ministria e Kulturës, që erdhi në qendër të vëmendjes së opinionit publik nëpërmjet një urdhri, sipas të cilit do të jepen me koncesion, ose në artikullimin e moderuar "do menaxhohen së bashku me partnerët publikë e privatë", monumentet e kulturës në Shqipëri, në administrim të MK dhe institucioneve të varësisë.

Ajo që mësuam menjëherë pas publikimit të këtij lajmi³⁸ ishte se ky urdhër ishte firmosur nga ministrja e Kulturës që në muajin tetor të vitit 2015 dhe publikimi i tij në fletoren zyrtare u bë vetëm në datën 17 mars 2016.

Së pari, këtu kemi një shkelje të të drejtës së informimit publik nga ana e institucioneve shqiptare, pasi urdhri u publikua rreth 5-6 muaj me vonesë. Më tej, shumë specialistë të fushës apo opinionistë të ndryshëm dhe media kanë kontestuar faktin se për hartimin e këtij vendimi nuk janë konsultuar grupe interesi dhe specialistë të trashëgimisë kulturore. Ndërmarrja e një hapi të këtillë nuk është paraprirë nga transparenca, ndërkohë që formulimi i urdhrin është bërë pa zhvilluar më parë një debat mbi çështjen në fjalë.

Shqetësimi kryesor lidhet me aftësitë menaxhuese të këtij institucioni të një rëndësie të veçantë për sa u përket pasurive kombëtare dhe ruajtjes e mirëmbajtjes së tyre. Sikurse do të thoshte në të shkuarën ministrja e kulturës gjatë një interviste, "ne nuk kemi prioritete se të gjitha janë prioritete dhe të gjitha i kemi prioritete", një frazë që me sa duket përdoret për të justifikuar përpjekjet e institucionit për të dalë nga

³⁸Faqja Zyrtare e MK

<http://www.kultura.gov.al/al/newsroom/deklarata-per-shtyp/per-udhezimin-e-mk-per-dhenien-me-qira-dhe-menyren-e-administrimit-te-monumenteve-te-kultures-me-qellim-rijetezimi&page=1>

kornizat e profilit të vet kur është fjala për para dhe bashkëpunëtorë. Ajo të çon natyrshëm në përfundime që vënë në dyshim aftësitë menaxheriale dhe vizionin e liderit të këtij dikasteri, po ashtu sikurse edhe veprimtaritë e ditëve të sotme, që projektojnë hijen e dyshimit mbi aftësitë bashkëpunuese dhe përgjegjshmërinë e MK-së në realizimin e punës sipas profilit të caktuar.

Pyetja që të vjen menjëherë ndërmend sapo ndeshesh me lajme të kësaj natyre, është: Sa i domosdoshëm është një urdhër veprimi i kësaj natyre? Çfarë ka bërë efektivisht MK-ja gjatë këtyre viteve për çështjet e trashëgimisë kulturore?³⁹A nuk ekzistojnë mundësi apo variante të tjera në funksion të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së këtyre aseteve kulturore?

Menjëherë pas replikave të shumta me të cilat u përball MK-ja pas publikimit të lajmit, ministrja e kulturës reagoi duke raportuar mbi situatën alarmante të monumenteve. Në vend të analizës për nivelin aktual të menaxhimit dhe organizimin e diskutimit publik mbi rrugëzgjdhjet e mundshme, Ministria e Kulturës e gjen me vend të justifikojë paaftësinë e vet dhe ta drejtojë vëmendjen nga privati, ndërkohë që përmes trajtimit të çështjes nga ana e medias është artikulluar qartë dyshimi nëse mund ta përballojë këtë detyrë delikate privati, i cili në plan të parë ka interesin për përfitime dhe reflekton një sens përgjegjësie gjithnjë në pikëpyetje?!⁴⁰

Sa punoi ky dikaster për përmirësimin e politikave, planeve të menaxhimit dhe koordinimit të punëve me institucionet e vartësisë? A mund të flitet për fuqizimin dhe rritjen e kapaciteteve të specialistëve të fushës si pjesë e punës me një perspektivë të qartë? A i ka shfrytëzuar ky dikaster kapacitetet aktuale të nëpunësve,

³⁹Gazeta Shqip

<http://www.gazeta-shqip.com/lajme/2016/03/25/ministria-e-kultures-dorezohet-nuk-i-mbajme-dot-monumentet/>

⁴⁰Vizion Plus Tv

<http://vizionplus.al/edhe-monumentet-tek-privati/>

partneriteteve dhe ekspertëve, a ka qenë ai bashkëpunues dhe i hapur me individë, specialistë, ekspertë, nëpunës për t'u konsultuar, për të vjelë ide, opinione mendime dhe t'i verë në funksion të hartimit të programeve apo strategjive të punën? A ka ky dikaster një strategji të mirëfilltë për ruajtjen dhe trajtimin e traditës kulturore, pjesë e së cilës janë edhe monumentet? A e njuh detyrimin për transparencë dhe respektimin e ligjit me anë të të cilit operon çdo ditë?⁴¹

Është me vend të theksojmë se vendi ynë ka nevojë për kualifikimin e mëtejshëm të individëve në aspektin e menaxhimit të objekteve të artit e kulturës, të strukturojë tregun e restaurimeve, të verifikojë në mënyrë sistematike nivelin e ekspertizës së kompanive restauratore, të përmirësojë mekanizmat e kontrollit shtetëror mbi sektorin privat si faktorë me peshë në rritjen e aftësive menaxheriale dhe hartimin e platformave solide në të ardhmen. Ndërkaq, përveç dhënies me qera nga 5 deri në 20 vjet (aspekti financiar i urdhrit), ky vendim i ministrisë nuk specifikon se cilat monumente kanë nevojë për restaurim, apo se çfarë lloj biznesesh mund t'i marrë ato me qira.⁴²

Në daljen publike për një deklaratë shtypi, Ministrja e Kulturës thotë se janë mbështetur në modelet të ri jetësimit dhe përdorimit të monumenteve të kulturës në Europë, edhe pse me ironi, pohohet se ligji për trashëgiminë nuk e lejon "udhëzimin" të bëhet plotësisht funksional paçka se në disa hapësira duket se e favorizon të ashtuquajturin partneritet publik privat. Në ndihmë të këtyre "garancive" do të ngrihet edhe një Komision i Posaçëm për Menaxhimin e Pasurive Kulturore, "që s'është aspak detyrim ligjor, por vullnet i ministrit të sotëm është edhe provë përgjegjshmërie, me të cilën ne e trajtojnë këtë çështje".

Ajo që dimë me siguri është se autoriteti më i lartë për të vendosur dhe për të thënë fjalën e fundit në çdo vendim dhe në aspektin ligjor në çështjet e kulturës dhe trashëgimisë, mbetet vetë titullari me i lartë i

⁴¹Gazeta Panorama

<http://www.panorama.com.al/ska-koncesion-per-kalate-buxheti-smjafton-per-tu-kuidesur/>

⁴²Gazeta Sot

<http://sot.com.al/politike/t%C3%AB-qjith%C3%AB-pasurit%C3%AB-e-shtetit-me-koncesion-qeveria-i-kalon-miliarda-lek%C3%AB-privatit-p%C3%ABr>

institucionit të kulturës, pra Ministri që e drejton, sikurse parashikon edhe urdhri në fjalë, edhe se kujt do t'i jepet e drejta e përdorimit të aseteve kulturore kombëtare me ose pa vendim komisioni.

MINISTRIA E MBROJTJES

Brenton KOTORRI, BA

1- Mish për top

Gjate muajit të fundit ministrja Kodheli bëri shëtitje nëpër gjimnazet e Shqipërisë për t'iu shpjeguar gjimnazistëve dhe të rinjve shqiptarë, se të bashkohesh me Forcat e Armatosura nuk është aq keq sa duket (!) Ajo përdori sidomos trukun e nxitjes së krenarisë femërore kur u thoshte vajzave se duhet t'iu tregojnë prindërve të tyre dhe gjithë shoqërisë se sa të emancipuara janë vajzat duke i shkelur paragjykimet e duke u futur në ushtri. Në fillim të muajit, ministrja mbajti një fjalë përshëndetëse përpara 960 aplikantëve, të cilët dëshirojnë të bëhen pjesë e ushtrisë shqiptare. Të gjithë janë të rinj, prej të cilëve vetëm 0.5% janë me diplomë universitare, dhe vetëm 0.5% janë vajza⁴³. Sigurisht që ky numër aplikantësh nuk do të thotë domosdoshmërisht numër të pranuarish, pasi parashikohet një moment përzgjedhjeje për më të mirët prej tyre; sigurisht që mund edhe të pretendohet se ky numër është shprehje e suksesit në çështjen e aplikimeve, e se këtë sukses e solli turi i ministres.

Mirëpo sa mund të quhet e tillë një fushatë rekrutimi për rishtarë në ushtri, kur nuk është ndërmarrë ende asnjë reformë trajtimi për oficerët në rezervë, që janë as të papunë e as të punësuar, as aktivë e as në pension? Sa e suksesshme mund të konsiderohet një fushatë që bën thirrje për ushtarë, por nuk bën thirrje për ekspertë. E themi këtë pasi asnjëherë nuk është bërë thirrje për shembull për të shtuar radhët e ekspertëve të sigurisë dhe mbrojtjes, madje shumëkush as që e di ekzistencën e një universiteti ushtarak shqiptar⁴⁴. Akademia e FA ofron edhe programe Master dhe Doktoraturë në studimet e Sigurisë dhe Strategjisë edhe për civilët, por prej vitesh thuajse asnjë civil nuk merr pjesë në kurs. Kështu pra duket sikur ministrja është e shqetësuar të ketë mish për top, ata që shpëtojnë do bëhen topçinj dikur, por për të përcaktuar se ku duhet vendosur e

⁴³Mbyllet rekrutimi it e rinjve për ne FA <http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/newsroom-2/1634-mbyllet-fushata-e-rekrutimeve-per-ne-fa>

⁴⁴Faqja zyrtare online e KDS <http://www.tradoc.mil.al/>

si duhet lëvizur topi duket se FA nuk ka nevojë.

Topi është në fushën e ministres dhe ministrisë që përmes teknikienëve të vet duhet të përcaktojnë një program rekrutimi për të gjithë studentët e ekspertët më të mirë të Marrëdhënieve Ndërkombëtare e më gjerë, të cilët mund të kontribuojnë me ndihmë për sa u takon çështjeve të sigurisë, terrorizmit, aleancave ushtarake (NATO), etj.

2- VKM FA

Në VKM-në e datës 2 mars, kryeministri ka firmosur për dhënien e dietave ndaj oficerëve të Forcave të Armatosura, edhe në raste kur këta kryejnë kurse. Kjo të bën të mendosh se deri më tani, dietat e këtyre rasteve nuk akordoheshin. Një korrigjim me vend nga qeveria nëse e mendon shkurt. Nëse vendos ama të mendosh më thellë, kupton që kjo është një asgjë në kushtet kur Trajtimi i Forcave të Armatosura ka nevojë për një reformë themelesh, që kurrë nuk ndodhi edhe pse ishte e mezipritur me hyrjen në NATO. Për më tepër mbi rrogat e gradave të FA, mund të gjeni në raportin e APPAs së muajit korrik 2015⁴⁵.

Ndër VKM-ra, jo vetëm të këtij muaji duket se sa shumë prona që dikur i përkisnin Ministrisë së Mbrojtjes: tashmë, thjesht me një firmë të kryeministrit dhe me heshtjen e znj. Kodheli, pronat publike të MM, i transferohen lehtësisht subjekteve të tjera shtetërore, dhe shumë shpesh subjekteve të ndryshme private. Pronat ushtarake, jo më kot janë përcaktuar të tilla pasi shpesh paraqesin pozicione strategjike, mirëpo duket sikur strategjinë tanimë nuk e bën më Ministria e Mbrojtjes për llogari të shtetit, por subjekti privat për hir të biznesit.

3- Dëme dhe lëvdata

Në buletinin e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 4, janar-dhjetor 2015⁴⁶, Ministria e Mbrojtjes rezulton me dëm ekonomik dhe abuzim ndaj shtetit në vend të tretë pas O.S.T-së dhe O.SH.E-së. Paçka se në dokument emërohen qartazi zyrtarët përgjegjës, në ministri nuk ka ndodhur asnjë

⁴⁵Raporti APPA maj '15 <http://appa.al/raport-maj-2015-ministria-e-mbrojtjes/>

⁴⁶Buletini 4 K.L.SH. http://www.klsh.org.al/web/pub/buletini_4_2015_copy_2_2366_1.pdf

mea culpa, asnjë apologji, asnjë qortim, dhe aq më pak asnjë shkarkim.

Në kontrast me këtë fakt, në progres raportin e Komisionit European për Shqipërinë për vitin 2015, thuhet fjalët më të mira për politikën e mbrojtjes dhe sigurisë. Në pamje të parë mund ta gëzojmë këtë lëvdatë, mirëpo nga ana tjetër në raport specifikohet se qëndrimet e Shqipërisë janë të duhurat sepse "(Ndjekin 100%)" direktivat e BE-së. Thënë ndryshe, lëvdatë për të lavdëruar ata vetveten. Sugjerojmë që për çdo rast, Ministria e Mbrojtjes të mbledhë teknikienët më të mirë të vendit dhe të analizojë çdo kazu hap pas hapi, e jo të nxitojë që të jetë e para për t'iu bindur BE-së.

MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË

Ingrid XHAFA, MSc

1- Mirëqenia shqiptare fluturon me sukses drejt SHBA-ve

Ministri Klosi ndërmori një udhëtim zyrtar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me rastin e mbajtjes së sesionit të 60-të të Komisionit mbi Statusin e Gruas në OKB. Vizita shërbeu gjithashtu për të bërë disa takime me zyrtarë të lartë të Departamentit të Shtetit, ku ndër të tjera u diskutua progresi i qeverisë shqiptare në lidhje me reformat e ndërmarra për rritjen e mirëqenies dhe shtrirjen e mëtejshme të bashkëpunimit me një sërë aktorësh ndërkombëtar. Në të gjitha rastet, ministri e prezantoi Shqipërinë si një histori suksezi, veçanërisht në lidhje me gjitha reformat që MMSR-ja ka ndërmarrë. Mirëpo, pavarësisht kësaj, për secilën çështje të axhendës ekzistojnë një sërë problemesh.

2- Përfaqësimi gjinor

Në fjalën e mbajtur në Komisionit mbi Statusin e Gruas në OKB, ministri e prezantoi Shqipërinë si një model suksezi për respektimin e kuotave gjinore, kryesisht në nivelet e larta të vendimmarrjes. Megjithëse në kabinetin e qeverisë shqiptare janë 8 gra në pozicionin e ministreve, duke përbërë kështu 42 % të tij, në kuvendin e Shqipërisë kjo prani nuk është më shumë se 25%. Për më tepër, të dhënat që mendohet se na ekspozojnë si një vend lider në Europë në lidhje me përfaqësimin gjinor në qeverisjen lokale, në mos qëllimisht të manipuluar, janë të pasakta. Kështu, është e vërtetë që sipas Kodit Zgjedhor në listat e kandidimit për këshillat bashkiake në zgjedhjet e 2015-tës gratë dhe burrat ishin të përfaqësuar 50% me 50%, megjithatë ka një dallim mes kandidimit dhe produktit politik. Deformimi i kuotës gjinore të shpallur dhe përfaqësimi real gjinor është cilësuar prej vitesh si problem në raportet e OSBE- ODHIR për vlerësimin e standardeve zgjedhore në Shqipëri⁴⁷. Kështu, zgjedhjet e fundit lokale të 2015-tës prodhuan vetëm 2 bashki me

⁴⁷ Për më tepër, shih këtu :

<http://www.osce.org/odhir/elections/albania/153461?download=true>

përfaqësim të barabartë mes grave dhe burrave në këshillat bashkiakë, kurse të tjerat vazhdojnë të kenë një hendek të madh gjinor, duke penalizuar gratë⁴⁸. Paçka përfaqësimit të pamjaftueshëm të grave në nivele të larta të vendimmarrjes, ajo që mbetet vërtet shqetësuese është gjendja e përgjithshme e grave dhe e vajzave. Shqipëria renditet në vendin e 70-të nga 109 në raportin e 2015 të *World Economic Forum* mbi Hendekun Gjinor. Edhe pse është përmirësuar me 13 vende në krahasim me 2014-tën, ajo konsiderohet si vendi që ka pasur progresin më të vogël në rajon në 10 vitet e fundit⁴⁹. Shqipëria renditet ndër 10 vendet që performojnë më dobët në botë në lidhje me hendekun gjinor në shëndetësi dhe nën indeksin e mbijetesës⁵⁰. Për më tepër, dhuna me bazë gjinore dhe vrasjet e grave si pasojë e dhunës në familje vazhdojnë në nivele të larta. Një në dy gra në Shqipëri përjeton dhunën në familje.

3- Reforma e Pensioneve

Një tjetër model suksezi i prezantuar nga ministri Klosi ka qenë reforma e pensioneve e ndërmarrë nga qeveria shqiptare në vitin 2014. Përveç faktit që reforma është realizuar si një domosdoshmëri e kohës, duke qenë se skema e mëparshme të pensioneve ishte konsideruar përveçse e padrejtë, tërësisht jo efikase, sipas ekspertëve të qeverisë skema aktuale e pensioneve është edhe modeli më i mirë i reformimit të skemave të pensioneve në gjithë rajonin. Në fakt, reformat e një natyre si ajo e pensioneve, që e tejkalon natyrën strukturore të reformave të përgjithshme, mund të konsiderohen të suksesshme apo të dështuara në një kohë shumë më të largët, rreth 20-30 vjet më vonë nga faza fillestare e implementimit dhe indikatorët e kontrollit vetëm një vit mbas futjes së skemës së re në zbatim nuk tregojnë shumë për situatën reale pas reformës. Megjithatë, ministri Klosi ka deklaruar se analiza e indikatorëve të deritanishëm tregon se kjo reformë është shembull për gjithë rajonin. Ndër indikatorët e vlerësuar është ulja e deficitit mes kontribuuesve dhe përfituesve të skemës, që konsiderohet edhe si arritja më e madhe e

⁴⁸

<http://www.shekulli.com.al/m/post.php?id=326416#sthash.Sn5aTaO8.dpbs>

⁴⁹<http://www3.eeforum.org/docs/GGGR2015/cover.pdf>

⁵⁰ Po aty, fq 17

reformës. Në fakt, nëse mbahet parasysh fushata agresive e ndërmarrë nga Ministria e Financave, veçanërisht nga drejtoritë tatimore në vend me qëllim luftën ndaj informalitetit në punë dhe deklarimit të punonjësve në organin tatimor, duket se më shumë se fryt i reformës, rritja e numrit të kontribuuesve është përmirësuar nga një aksion ad-hoc qeveritar, i cili mund t'i ketë rezultatet jo afatgjata.

Probleme të tjera, që kanë të bëjnë me reformën, lidhen me atë pjesë të konsiderueshme të popullsisë, e cila do të preket negativisht nga skema e re e pensioneve - shkelje kjo e parimeve të drejtësisë sociale dhe asaj morale. Ata që penalizohen janë kontribuues që përgjatë viteve kanë paguar sigurimet shoqërore në bazë të pagës minimale. Duke qenë se ligji i vjetër i pensioneve e llogariste skemën e kontributeve mbi pagën bruto, kurse skema aktuale e llogarit kontributin mbi pagën neto, kjo kategori do të marrë më pak para se pjesa tjetër e shoqërisë përgjatë gjithë jetës së tyre, para dhe mbas ciklit të punës. Duke konsideruar se kjo është edhe pjesa me të ardhurat më të ulëta të popullsisë, edhe pse përgjatë viteve pensioni i tyre do të rritet gradualisht sipas parashikimeve të skemës, ata do të mbeten pjesa e shoqërisë që do të vazhdojë të ketë të ardhurat më të ulëta (nga pensioni) në shoqëri. Kurse nga ana tjetër, edhe ata njerëz që përgjatë jetës kanë punuar shumë, kanë pasur paga të larta dhe në total paguajnë më shumë nga sa do të përfitojnë pension, konsiderohen nga ekspertët e majtë të qeverisë si solidarë. Për ta, kjo dukuri shihet si diçka e natyrshme! Pra skema në fjalë nuk parashikon të pajtojë të dy situatat e mësipërme në mënyrë që të zbusë sado pak pabarazinë sociale dhe atë morale, por mjaftohet me pretendimin se kjo është një skemë më e mirë sesa ajo pararendëse, që po e çonte sistemin drejt falimentimit.

Së fundi, ndërkohë që ekspertët e ministrisë argumentojnë si arritjen më të lartë të skemës së pensioneve rritjen reale të pensioneve krahasuar me ato të reformës pararendëse, duhet theksuar se rritja e pensioneve në kohën kur shoqërohet me rritjen graduale të moshës së daljes në pension (67 vjeç për burrat dhe 65 vjeç për gratë), në kushte dhe standarde pune të pa përshtatmë dhe larg parametrave europiane,

është e debatueshme nëse e gjithë kjo përkthehet realisht në rritje të mirëqenies së individit në cilëndo fazë të jetës së tij apo jo.

Si përfundim, edhe pse është detyrë e ministrit të prezantojë brenda dhe jashtë vendit arritjet e politikave të ndryshme socio-ekonomike që ndërmerren në Shqipëri, do të ishte më me vend dhe serioze nëse këto deklarime do të shoqëroheshin me raporte progresi (afatshkurtër/ afatmesëm) mbi secilën politikë/reformë të ndërmarrë. Duket jo shumë shpresëdhënëse e ardhmja e shkurtër e aktivitetit të ministrisë, e cila nga një anë trumbeton me të madhe përtej oqeanit suksesin në lidhje me rritjen e mirëqenies sociale, sidomos në lidhje me grupet më të prekshme të shoqërisë, por nga ana tjetër edhe pse pretendon të ketë një rritje të buxhetit nominalisht me 4.3 % në krahasim me vitin 2015, në fakt nuk ka asnjë ndryshim në buxhetin e 2016-tës në raport me PBB-në. Kështu, projekt buxheti i MMSR-së për vitin 2016 është 27.63%, apo në vlerë absolute 73.7 mld. lekë. E shprehur në raport me PBB kjo vlerë është 4.81%, e njëjtë po të krahasohet me raportin e vitit 2015 që ishte 4.82%⁵¹. Nëse do ndiqet parimi se reformat e mëdha kërkojnë shumë të ardhura, atëherë është e vështirë të priten ndryshime të mëdha prej ministrisë për vitin 2016.

⁵¹MONITORIMI I PROJEKT BUXHETIT
https://www.osfa.al/sites/default/files/osfa_monitorimi_i_projekt-buxhetit_2016.pdf

MINISTRIA E MJEDISIT

Flutura GJANA, MSc

1- Moratoriumi i gjuetisë

Më 30 janar 2014, u ndalua me ligj⁵² ushtrimi i gjuetisë në të gjithë territorin e vendit për një periudhë 2 vjeçare. Afati i këtij ligji mbaroi më 15 mars të këtij viti. Por a ka funksionuar ky moratorium? Si ka ndikuar ai mbi faunën e vendit tonë? A ka arritur Inspektorati i Mjedisit të kontrollojë dhe të sigurohet për zbatimin e ligjit? Pikërisht për këto çështje priten shpjegime nga Ministria e Mjedisit dhe institucionet që janë në varësi të saj. Deri në tani nuk është publikuar asnjë analizë rreth efektit që ka pasur zbatimi i këtij moratorium 2 vjeçar.

Kanë qenë dy shoqata, përkatësisht Shoqata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA) dhe Shoqata për Ruajtjen e Shpendëve dhe Gjitarëve të Shqipërisë (ASPBM), që janë shqetësuar për shkeljet e vazhdueshme që ka pasur moratoriumi i gjuetisë. Rastet e shkeljeve janë faktuar nga vëzhgimi në terren i grupeve të monitorimit, që kanë ngritur këto shoqata.

Sot, pothuajse pas dy viteve, konstatojmë se përmbushja e objektivave të moratoriumit të gjuetisë nuk është realizuar. Gjuetia e paligjshme vazhdon të ushtrohet dhe muajt e fundit është rritur edhe më shumë. Intervali kohor kur aplikohet gjuetia e paligjshme përfshin orët e mbrëmjes dhe orët e para të mëngjesit, kryesisht gjatë fundjavës. Jo rastësisht, për abuzuesit është e preferueshme gjuetia në këto orare, pasi në këtë periudhë kohore organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit kanë një vigjilencë të ulët për sa i përket kontrollit të terrenit, për të mos thënë zero. Abuzuesit ushtrojnë gjueti pothuajse në të gjitha zonat e mbrojtura ligatinore, por edhe në zonat e mbrojtura malore, që kanë qenë në fokus të monitorimit. Nuk janë kursyer llojet e rralla të kafshëve që janë pjesë e listës së kuqe të

⁵² Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 28 Shkurt 2014 - Ligji nr. 7/2014 "Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë" (http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/20-2014.pdf)

faunës së Shqipërisë, si kaprolli, ujku, derri i egër etj.

Moratoriumi është aplikuar te qytetarët që kanë një leje gjuetie, kurse pjesa tjetër, pra mbi 130.000 armëmbajtës që kanë gjuajtur pa leje gjuetie, pritej që do të vazhdonin të gjuanin pa leje sepse juridikisht ata e kanë pasur edhe më parë të ndaluar gjuetinë. Logjikisht nuk duhet të ishte vendosur një moratorium për gjuetinë por për armët, pra bllokimin e armëve të gjahut.

Ministri Koka ka deklaruar që po mendohet shtyrja⁵³ e këtij moratoriumi edhe për dy vite të tjera. Por para se të merret një vendim i tillë i bëjmë thirrje Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Rendit dhe organeve përgjegjëse për zbatimin e ligjit që së pari të marrin masa për mirëfunksionimin e këtyre institucioneve që të vënë nën kontroll gjuetinë e paligjshme, duke mbrojtur kështu pjesën tashmë tej të rrezikuar të faunës së egër në Shqipëri.

2- Ajri që thithim

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka deklaruar⁵⁴ se ajri në Tiranë vazhdon të jetë i ndotur dhe nuk ka asnjë përmirësim. Kjo gjendje alarmante shfaqet edhe në qytetet e tjera të Shqipërisë. Sipas specialistëve, ndotja e ajrit në këto nivele të larta vjen si pasojë e shumë faktorëve, ndër të cilët më kryesorët mbeten: automjetet e vjetërsuara, trafiku në zonat urbane dhe djegia e mbeturinave vend e pa vend. Është me vend të citoj objektivin⁵⁵ e Ministrisë së Mjedisit në lidhje me cilësinë e ajrit ku thuhet:

*"... për të mundësuar parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës dhe shëndetit të njeriut duke synuar përmirësimin e cilësisë së ajrit në masën **8%** ..."*

Por çfarë ka bërë dhe po bën Ministria e Mjedisit për këtë problem madhor, ndërkohë që është në dijeni se çdo vit 500 vdekje në qytet i atribuohen ndotjes së ajrit? A do

⁵³ Video: Moratoriumi i gjuetisë, Koka: Mund të shtyhet dhe për dy vite (<https://www.youtube.com/watch?v=YOfu2e-vwrc>)

⁵⁴ Video: Qytetet, smog dhe zhurmë (<https://www.youtube.com/watch?v=9WHuBpXq53Y>)

⁵⁵ Artikull: Objektivat (<http://www.mjedisi.gov.al/al/ministria/misioni-dhe-objektivat/objektivat>)

mundet Ministria jonë e Mjedisit të përmbushë këtë objektiv brenda vitit 2017?

Jemi në situatën ku ndotja e ajrit është mbi normat e lejuara nga BE-së dhe kjo po shkakton pasoja të parikuperueshme mbi shëndetin, e për pasojë po ulet jetëgjatësia e njerëzve. Ekspertët paralajmërojnë se nëse nuk merren masa urgjente, rënia e pritshme e jetëgjatësisë së popullsisë, sidomos asaj që jeton në kryeqytet, do të jetë 1- 2 vjet për çdo banor. Për të njëjtën arsye (ndotjes së ajrit), çdo vit shfaqen rreth 1400 raste të reja me kancer (sidomos ai i mushkërive dhe lëkurës).

Në aspektin ligjor, ministria siguroar miratimin e ligjit⁵⁶ Nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis" dhe vendimit⁵⁷ Nr. 594, datë 10.09.2014 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit".

Sa po zbatohet ky ligj? A po realizohen masat për të cilat qeveria është zotuar në Strategjinë Kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit? Mos ndoshta përveç përpilimit të politikave të mëdha, kemi nevojë dhe për disa nisma të vogla, por më të prekshme, për të minimizuar sado pak këtë rrezik që i kanoset çdo njeriu që banon në territorin shqiptar?

Këto të dhëna janë mjaft alarmante dhe nevojitet menjëherë një ndërhyrje për përmirësimin e situatës, duke shtuar se plan veprimi për cilësinë e ajrit duhet të ketë vëmendjen e duhur në terma ligjorë institucionalë, programorë dhe financiarë. Prandaj i kërkojmë ministrisë të marrë masat e duhura, sepse detyra e saj është të sigurojë cilësinë e jetës për çdo njeri.

⁵⁶ Ligji Nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis"

⁵⁷ Vendim Nr. 594, datë 10.09.2014 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit"

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Megi LLUBANI, MSc

1- Ministri paradoksesh

Në një kohë kur muaji mars u "njollos" nga dhuna e vazhdueshme e policisë së shtetit dhe asaj bashkiake kundrejt një grupi protestuesish kundër betonizimit të liqenit artificial të Tiranës, si e vetmja hapësirë e gjelbër e mbetur në kryeqytet, Ministria e Brendshme e nis muajin me një lajm sa ironik aq edhe absurd për përmirësimin e shërbimit cilësor dhe të qetë për qytetarët. Në një deklaratë për shtyp ministri Tahiri shprehet : " Ju e dini që në themel të punës tonë qëndron filozofia e shërbimit ndaj qytetarëve. Dhe mendojmë se punonjësi i policisë, para së gjithave, është një shërbyes i qytetarëve."⁵⁸

Në fakt ngjarjet e kohëve të fundit, që e kanë detyruar vetë ministrinë të marrë masa kundër punonjësve që ushtrojnë dhunë të pajustificuar mbi qytetarin, veshur nën petkun e pushteti të forcave policore, tregojnë se kjo filozofi është në rastin më të mirë thjesht e shkruar në letër dhe e trumbetuar e në rastin më të keq një propagandë boshe.

Në raportin e dy muajve të kaluar e njëjta problematikë u ngrit nga APPA, por në vend të një reflektimi institucional për të materializuar vërtetë "filozofinë" e pretenduar të policimit në komunitet dhe vendosjen e qytetarit në qendër të punës së forcave policore, duket se metodat e vjetra të mungesës së llogaridhënies dhe kuptimit të rolit të policisë së shtetit, janë rrënjësor në kulturën institucionale duke krijuar mospërputhje ndërmjet premtimeve dhe realitetit në terren. Sigurisht çdo iniciativë që lehtëson shërbimin ndaj qytetarit është e mirëpritur dhe fakti që Ministria po investon në krijimin dhe rikonstruksionin e sporteve të policisë rrugore si përmirësim infrastrukture është për t'u vlerësuar. Gjithsesi, në vend që të fokusohet në detaje

⁵⁸Ministria e Punëve të Brendshme. Cilësi dhe qetësi për qytetarin me sportelet e reja të policisë rrugore. Online: <http://www.punetebrendshme.gov.al/al/te-rejat/lajme/cilesi-e-qetesi-per-qytetarin-me-sportelet-e-reja-te-policise-rrugore&page=2>

të përgjithshme që nuk thonë asgjë për mënyrën e financimit të këtij projekti, ministria është e lutur të bëjë transparent donatorin, shumën e alokuar për këtë projekt, periudhën kohore të implementimit dhe informacione të tjera që jo vetëm do ta bënin projektin më transparent në sytë e publikut dhe grupeve të interesit, por do të krijonin edhe mekanizma për llogaridhënien.

2- Ku qëndron kufiri ndërmjet private dhe publike?

Disa muaj më parë Ministria e Brendshme paralajmëroi hartimin e një draft ligji mbi masat shtesë të sigurisë që duhen ndërmarrë nga subjektet private për të ndihmuar dhe lehtësuar punën e policisë së shtetit në krijimin e një ambienti më të sigurt e të mbrojtur kundër kriminalitetit. Në fakt, nëse shohim qëllimin dhe filozofinë e ligjit duhet vlerësuar fryma e krijimit të një bashkëpunimi më të ngushtë ndërmjet subjekteve publike e private dhe policisë së shtetit për të siguruar kushtet për më tepër siguri. Megjithatë ligji duhet të ketë parasysh disa konsiderata që lidhen me faktorë të tjerë, si për shembull e drejta e privatësisë, që gjithashtu rregullohet me ligj.

Dispozitat ligjore, sikurse janë parashikuar, krijojnë perceptimin e krijimit të një shoqërie "vëzhgimi" për shkak të "detyrimit" dhe imponimit që u bën subjekteve të përzgjedhura publike e private për t'u pajisur me kamera CCTV dhe mjete të tjera teknike që do të jenë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me operatorët qendrorë të policisë së shtetit.⁵⁹ Pyetja që ngrihet është : cilat do të jenë mekanizmat që do të sigurojnë se mjetet e vëzhgimit nuk do të keqpërdoren për interesa të ndryshme private nga ana e institucioneve publike e private si edhe nga ana e policisë. Cilat do të jenë mekanizmat e kontrollit, balancimit si edhe monitorimit? Mos vallë, edhe në këtë rast mund të krijohen kushte për abuzim me tenderimin e kamerave CCTV, sikurse u krijua me kasën fiskale? Nuk janë të pakta përvojat kur nisma ligjore, që tentojnë të rregullojnë një politikë publike në të mirë të kësaj të fundit, të keqpërdoren dhe keqinterpretohen duke cenuar interesin publik. Së fundi, lind gjithnjë pyetja : cili ka

⁵⁹Projekt ligj për masat shtesë të sigurisë publike. Online: http://www.parlament.al/ep-content/uploads/sites/4/2016/01/pligj_siguria_publike_24614_1.pdf

genë konsultimi publik i zhvilluar nga Ministria e Punëve të Brendshme për hartimin dhe prezantimin e këtij draft ligji? Ky është një ligj që prek një pjesë të mirë të komunitetit dhe grupeve të interesit e duhet të kishte konsultime të gjera me publikun. Ku janë njoftimet e ministrisë për këto konsultime në bazë të ligjit « Mbi Njoftimin dhe Konsultimin Publik »? Mos na duhet të pohojmë se ligjet në Shqipëri janë thjesht fjalë të hedhura në letër?

MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

Sokol KONDI, MSc

1- Ankaraja zbuloi ambasadën pa ambasador dhe ministrinë pa ministër

Po të lexosh një op-ed të publikuar nga ministri Ditmir Bushati në fund të muajit mars⁶⁰ lidhur me vizitën e tij zyrtare në Greqi si dhe perspektivat e marrëdhënieve dypalëshe, për shkak të frymës pozitive dhe objektivitetit të prezantimit, të krijohet përshtypja se kemi të bëjmë me një institucion serioz, i cili po e adreson siç duhet politikën e jashtme të vendit. Mirëpo, "Rilindja" e diplomacisë shqiptare, duket se është një fasadë, si shumë fasada të tjera që janë meremetuar dhe po meremtohen nga qeveria në këto dy vjet⁶¹. Për ta vërtetuar këtë mjafton të hidhet një vështrim (jo dhe aq i thelluar) se si vazhdojnë të funksionojnë prej dy vitesh e gjysmë misionet diplomatike dhe shërbimet konsullore të Republikës së Shqipërisë. Edhe pse është dekretuar nga Presidenti Bujar Nishani që më 10 shkurt⁶², ambasadori Gent Gazheli nuk rezulton sipas ueb-sajtit zyrtar të ambasadës së Shqipërisë në Turqi që ta ketë marrë një detyrë të tillë. Zoti Gazheli nuk ka ngurruar ta bëjë edhe *sponsored* faqen e tij në Facebook, ku shkruhet qartë se ai është ambasadori i vendit tonë në Ankara, por ndërkohë nuk është kujdesur që këtë ndryshim statusi ta paraqesë edhe në një burim të rëndësishëm informacioni sikurse është faqja në internet e selisë diplomatike që ai përfaqëson. Është qesharake, që pasi më shumë se një muaji në detyrë, në sajtin e kësaj ambassade figuron me CV dhe të dhëna të plota ambasadori i vjetër, z. Genci Muçaj⁶³.

Por problemet në diplomaci nuk ndalen vetëm te sfera teknike, e cila sikurse kemi raportuar në muajt e kaluar, mund të lidhet me numrin e vogël të personelit nëpër

ambasada ose me keqpërdorimin e burimeve njerëzore në to. Mjafton të kujtojmë këtu se atentati i rëndë në Ankara nuk u pasqyrua në faqen zyrtare të kësaj ambassade që paguhet, me taksat e shqiptarëve.⁶⁴

Ndryshe nga rasti i Brukselit⁶⁵, kur Ministria e Jashtme dhe ambasada jonë në Bashkimin Europian vunë menjëherë në shërbim të qytetarëve një numër kontakti dhe mbajtën një qëndrim zyrtar, në rastin e atentatit të Ankarasë, ku pati edhe më shumë viktime, nuk u pa e njëjta gatishmëri. Një gjë e tillë tregon njëfarë amullie dhe çoroditjeje në përballimin e emergjencave. Ambasadat nuk mund të vazhdojnë të punojnë me dy standarde, pra në një rast të tregojnë vigjilencë dhe gatishmëri, ndërsa në raste të tjera jo, kur bëhet fjalë për sulme të ngjashme të armatosura që shkaktojnë shumë viktime dhe që rrezikojnë edhe jetën e qytetarëve shqiptarë, të cilët ndodhen jashtë. Në raste të tilla, do të ishte më profesionale dhe e udhës që ambasadat të vepronin me një plan të hartuar për situata të tilla ekstreme dhe të unifikuar, dhe jo në varësi të shijeve apo ndjeshmërive të momentit të Tiranës zyrtare. Gjithashtu, Ministria e Punëve të Jashtme bën mirë të koordinohet me Ministrinë e Mbrojtjes dhe të mos e lejojë këtë të fundit që të bëjë punën që i takon me ligj të parës. Ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli, për herën e dytë radhazi u bë raportuese e situatës së atentateve të Ankarasë⁶⁶. Cilado qoftë arsyeja, kjo përbën një tejkalim kompetencash dhe ndërhyrje në punët e një ministrie tjetër.

Për kujdesin e interesave të qytetarëve shqiptarë që ndodhen jashtë vendit është përgjegjëse Ministria e Punëve të Jashtme, një detyrim ky jo vetëm ligjor, por mbi të gjitha kushtetues. Është tejet joprofesionale kjo mbivendosje kompetencash dhe anashkalim detyrimesh. Vetëm duke iu referuar rastit të atentatit të Ankarasë dhe mënyrës së trajtimit të saj nëpërmjet

⁶⁰ Op-ed i Ministrit Ditmir Bushati lidhur me marrëdhëniet Shqipëri-Greqi <http://www.mapo.al/2016/03/nga-diplomacia-e-barrikadave-drejt-bashkepunimit-pa-tabu>

⁶¹Footnota 2

⁶²Lajmi për dekretimin e Ambasadorit Gent Gazheli në Turqi <http://www.mapo.al/2016/02/nishani-dekretion-gazhelin-berisha-e-guajti-lavatrice>

⁶³ Ueb-sjati i ambasadës shqiptare në Ankara, profili i ambasadorit <http://www.ambasadat.gov.al/turkey/sq/ambasadori>

⁶⁴ Ueb-sjati zyrtar i ambasadës shqiptare në Ankara, asnjë referim për sulmet vdekjeprurëse <http://www.ambasadat.gov.al/turkey/sq>

⁶⁵ Postim i MPJ ne Facebook për atentatin ne Bruksel <https://www.facebook.com/notes/ministria-e-pun%C3%ABve-t%C3%AB-jashtme-republika-e-shqip%C3%ABris%C3%AB/mpi-d%C3%ABnon-sulmet-terroriste-n%C3%AB-bruksel/950210995093740>

⁶⁶Postim i ministres Kodheli ne Facebook për situatën e atentatit ne Ankara https://www.facebook.com/kodheli.mimi/posts/973412309408776?_mref=message_bubble

qëndrimeve zyrtare të Tiranës, që paraqitëm më sipër, të krijohet përshtypja sikur në vendin tonë "vëlla" nuk kemi ambasador dhe se në MPJ nuk kemi ministër. Shpresojmë që MPJ të ketë mirësinë t'i ndreqë këto "vogëlsira".

2- Traktat miqësie apo traktat i fshehtë mes Shqipërisë dhe Greqisë?

Ministri i Jashtëm Ditmir Bushati ka qenë për një vizitë zyrtare në Greqi gjatë muajit, në kuadër të një gjallërimi dhe intensifikimi të marrëdhënieve mes dy vendeve. U prekën dhe u diskutuan tema që kanë qenë tabu gjatë këtyre 25 vjetëve, si dëbimi i çamëve shqiptarë nga Greqia gjatë Luftës së Dytë Botërore.⁶⁷ Gjithashtu z. Bushati kërkoi shfuqizimin e Ligjit të Luftës me Shqipërinë, të cilin pala greke nuk e ka hequr ende me një vendim të parlamentit⁶⁸. Bisedimet shënojnë hapa përpara dhe gjuha zyrtare e përdorur le vend të shpresohet për zgjidhje të rëndësishme në dobi të të dyja shteteve. Por veç problemeve publike të trajtuara, ka edhe tema të cilat me sa duket janë të fshehta, të paktën për sa i takon palës shqiptare.

Kushtetutat e vendeve demokratike dhe Karta e San Franciskos apo Konventa e Vjenës mbi Traktatet, mbi të cilat mbështeten gjerësisht marrëdhëniet ndërkombëtare të shteteve, i ndalojnë kategorikisht traktatet e fshehta. Shqipëria dhe Greqia kanë një traktat miqësie të nënshkruar prej tyre në vitin 1996. Mirëpo teksti i këtij traktati duket se është misterioz apo i fshehtë, të paktën për sa i takon anës shqiptare të medaljes. Teksti i tij nuk mund të gjendet as në ueb-sajtin e Parlamentit, organi që e ka miratuar, as në sajtin e ambasadës shqiptare në Greqi dhe as në ndonjë burim online të MPJ. Por nuk mbaron me kaq. Në një e-mail që i kemi dërguar Arkivit Historik në MPJ kemi marrë një përgjigje befasuese.

Duke qenë se në një republikë demokratike nuk mund të akte shtetërore të fshehta, e aq më pak ato që miratohen nga parlamenti, përgjigja zyrtare e ministrisë lidhur me kërkesën tonë për të pasur akses te teksti i

traktatit në fjalë, që mban datën 7 janar 2016 dhe emrin e punonjësës me inicialet D.T. , ka qenë e mëposhtmeja: "*Dokumenti që kërkoni në Arkivin Historik të MPJ i përket v.1996. Ligji mbi arkivat në Shqipëri lejon publikimin e dokumenteve arkivore 25 vite pas krijimit të tyre. Ne sapo hapëm dokumentacionin arkivor te vitit 1991.*"

Sipas ligjit, vetëm dokumentet sekrete nuk mund të vihen në dispozicion të publikut. Si mund të hulumtojnë studiuesit, por mbi të gjitha si mund ta ushtrojë kontrollin e tij ndaj parlamentit dhe institucioneve publike sovrani taksapagues, kur shteti i tij që e ka detyrim kushtetues transparencën dhe llogaridhënien, kthehet në një bunker. Termi bunker, që e kemi përmendur edhe në raportet e kaluara të APPA-s, nuk është një etiketim politik, por një konstatim lidhur me funksionimin e institucionit të MPJ-së, që mund të përmblihet me dy fjalë: Jo-transparent dhe hermetik.

3- Konsuj me mik

Muaji mars nisi me një skandal. Konsullata në Milano, e denoncuar disa herë edhe nga një deputet i parlamentit shqiptar për keqfunksionim, ra pre e një filmimi të fshehtë, ku duket se konsullja e përgjithshme lëshon një certifikatë fiktive martesore kundrejt 800 eurove⁶⁹. MPJ mori masa duke e larguar konsullen e përgjithshme Luljeta Çobanaj nga shërbimi jashtëm. E kemi trajtuar disa herë çështjen e konsullatave gjatë vitit 2015.

Kemi konstatuar në tre raste se përzgjedhja e konsujve është e papërshtatshme për shërbimin e jashtëm. Në Selanik, Shqipëria përfaqësohet nga një konsulle ish-sportiste, në Bari nga një konsulle që ka qenë ish-Miss Shqipëria dhe nga një konsull militant politik, pa diplomë masteri, kryetar i Partisë Socialiste të Barit. Znj. Çobanaj ishte një tjetër e emëruar politike pa përvojë diplomatike. Konsuj të tillë, që zgjidhen me mik, janë në dëm të shërbimit të jashtëm shqiptar, sikurse dëshmoi rasti flagrant i ish-konsulles.

⁶⁷ Vizita e Bushatit në Greqi, trajtimi i çështjes çame: http://shqiptaria.com/news.php?id_legami=202484

⁶⁸ Bushati në Greqi, çështja e Ligjit të Luftës: <http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=322259#k1>

⁶⁹ Skandali me konsullen në Milano, <http://tvklan.al/web/skandal-ne-konsullaten-shqiptare-ne-milano-denoncimi-ne-emisionin-stop/>

MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Adela DANAJ, BA

1- Raporti i Këshillit të Europës- "Shqipëria: kushte të rënda në dhomat e paraburgimit dhe dhomat e kujdesit shëndetësor në burgje"

Pas raportit të publikuar më 3 mars 2016 nga Këshilli i Europës⁷⁰, u mendua që jo vetëm Ministria e Shëndetësisë, por dhe media do të reagoje menjëherë duke kontribuar në ngritjen e problematikës në nivel kombëtar. Por, nga data 3 mars e deri tani nuk rezulton asnjë reagim nga ministria dhe asnjë lajm nga media shqiptare. Sipas raportit vjetor të anti-torturës, realizuar dhe më pas publikuar më 3 mars të këtij viti nga Këshilli i Europës, çështja e Shqipërisë duket të jetë ngritur si një ndër rastet më problematike sa i përket kujdesit shëndetësor në dhomat e paraburgimit dhe nëpër burgje. Kujtojmë që sipas statistikave vjetore të Këshillit të Europës, gjatë vitit 2014 Shqipëria është renditur në vendin e pestë në Europë me burgje të mbipopulluara, duke pasur 128 të burgosur për 100 vende⁷¹. Kjo do të thotë: më shumë kujdes ndaj tyre, kontroll shëndetësor konstant dhe krijimi i kushteve mjekësore për rastet urgjente.

Në faqen kryesore të raportimeve rreth studimeve të realizuara nga Këshilli i Europës, në seksionin e të Drejtave të Njeriut dhe Anti-torturës, shfaqet dukshëm raporti nën titullin "Shqipëria: Kushte të rënda në dhomat e paraburgimit dhe dhomat e kujdesit shëndetësor nëpër burgje." Raporti i KE-s është rrëqethës teksa paralajmëron se Komiteti për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor ose Degradues (CPT) ka evidentuar një situatë alarmuese në lidhje me (i) mos plotësimin e kushteve mjekoligjore; (ii) gjendjen psikike të të dënuarve; (iii) mos përmbushjen e kushteve që

⁷⁰Council of Europe: Human Rights Europe: <http://www.humanrightseurope.org/2016/03/albania-poor-detention-conditions-and-prison-healthcare-revealed-in-new-anti-torture-report/> aksesuar për herë të fundit më 25 Mars 2016

⁷¹Council of Europe Annual Penal Statistics <http://wp.unil.ch/space/space-i/prison-stock-2014-2015/> aksesuar për herë të fundit më 25 Mars 2016

parashikon ligji nëpër qendrat spitalore pranë institucioneve ku të dyshuarit dhe dënuarit presin apo vuajnë dënimin e tyre. CPT raporton për kushte ekstreme të dhomave të kujdesit shëndetësor në burgjet e të gjithë vendit, duke përjashtuar vetëm qytetet Tiranë dhe Korçë. Ai pohon se Saranda është një nga rastet më problematike, që në mënyrë absolute nuk plotëson as kushtet minimale për garanci shëndetësore apo kujdes shëndetësor në ambientet ku vuhet dënimi.

Raporti gjithashtu vë në dukje mungesën e ilaçeve dhe të shqyrtimit sistematik mjekësor të të burgosurve, kryesisht të sapoardhurve. Gjithashtu, CPT-ja ka bërë thirrje për krijimin e një strukture të specializuar psikiatrike për të burgosurit. Raporti në fund mbyllet me lajmin se autoritetet shqiptare janë vënë në dijeni për këtë situatë dhe po merren masat për të adresuar rekomandimet e CPT-ës.

APPA, sikurse dhe të gjithë të burgosurit dhe të afërmit e tyre, do t'i ishin shumë mirënjohëse Ministrisë së Shëndetësisë nëse do të merrte masa urgjente për të siguruar shëndetin dhe jetën e të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, qofshin apo jo të dënuar me heqje lirie.

Është e rëndë kur konstaton nëpërmjet ndërkombëtarëve se vetë shteti shkel me të dyja këmbët në mënyrë flagrante ligjet që ka miratuar po vetë. Kujtojmë se sipas ligjit Nr. 8328, miratuar më datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", neni 5 i tij garanton *Respektimin e të drejtave të njeriut* (ndryshuar me ligjin nr.40/2014, datë 17.4.2014) dhe neni 5/1 garanton *Parandalimin e dhunës dhe trajtimin e viktimave* (shtuar me ligjin nr.40/2014, datë 17.4.2014)⁷². Sipas ligjit të cituar, çdo të paraburgosuri apo dënuari duhet t'u sigurohen kushtet se dinjiteti i tyre dhe shëndeti nuk duhet të rrezikohen kurrsesi në asnjë moment. Megjithatë, sipas raportit të publikuar nga KE-ja ditët e para të muajit mars, konstatohet se asnjë nga këto kushte nuk është plotësuar duke vënë në rrezik

⁷²Ligji Nr.8328, Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve <http://www.qbz.gov.al/Ligje.pdf/LIGJ%20per%20te%20denuarit.pdf> aksesuar për herë të fundit më 25 Mars 2016

shëndetin dhe jetën e të paraburgosurve apo dënuarve.

Ministria e Shëndetësisë deri tani nuk ka bërë raportim të ngjarjes. Po ashtu, ajo nuk ka njoftuar nëse ka ndërmarrë ndonjë aksion të veçantë për të përmirësuar kushtet e qendrave shëndetësore pranë burgjeve, apo ndonjë përpjekje për të siguruar minimalisht barnat kryesore, të nevojshme për të dhënë ndihmën e parë. Në faqen e saj zyrtare raportohen vetëm lajme mbi instalimin e pajisjeve mjekësore në ndonjë qendër shëndetësore në vend⁷³. Asnjë lëvizje serioze dhe asnjë mbulim mediatik i kësaj situatë alarmante nuk shihet në horizont. Sigurisht që kjo është një përgjegjësi e drejtorisë së burgjeve, por Ministria e Shëndetësisë, menjëherë pas raportit të KE-s, duhet të ishte e para që të denonconte lajmin dhe të merrte masa serioze për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve të saj.

Nga ana tjetër, është i çuditshëm edhe qëndrimi i mediave, që vendosën të mos e mbulonin lajmin në fjalë. APPA do të përpiqet të kontaktojë drejtuesit e qendrave shëndetësore, të paktën në ato burgje që konstatohet se janë më problematike dhe nuk plotësojnë as kushtet minimale të kujdesit shëndetësor. Nëse nuk do të marrë asnjë reagim prej tyre, atëherë të gjitha kërkesat e veta do t'i adresojë në formën e kërkesave të hapura përmes të gjitha kanaleve të informimit që ka në përdorim.

⁷³ Ministria e Shëndetësisë
<http://www.shendetesia.gov.al/al/newsroom/lajme> aksesuar për herë të fundit më 25 Mars 2016

MINISTRIA E SHETIT PËR ÇËSHJET VENDORE

Mirilda TILI, BA

1- Vende pune pa punë

Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore këtë muaj do të marrë flamurin për sa i përket shpalljes së 1 mijë e ca vendeve të punës.⁷⁴ Dhe vende pune jo dosido, por në administratën publike, pra punë në shtet, që prej disa njerëzve konsiderohet "punë për qejf". Kjo mund të jetë krejtësisht e gabuar, por perceptimi i qytetarit për punën në shtet zë fill që kur pas njoftimit publik për vende pune, qendra që i shpall këto vende rezultojnë jashtë shërbimit. Dhe çka është më domethënëse: vendet për të cilat është bërë njoftimi publik janë thuajse të paarrishme për ata që duan të punësohen. Kjo për disa arsye. E para, nuk janë publikuar cilësitë dhe kualifikimet që kërkohen nga punëkërkuuesi. E dyta, janë shpallur si pozicione, por jo afatet e dorëzimit të dokumentacionit si dhe koha kur do të zhvillohen intervistat. Dhe e treta, që duket sikur ka edhe një histori nga pas, sa herë që flitet për vende pune në nivele drejtuese, tek të interesuarit shfaqet dyshimi në lidhje me atë se sa serioze dhe afatgjata do të jenë këto vende pune. Mjafton të kujtojmë vitin 2013 kur mazhoranca qeverisëse, në atë kohë ende në opozitë, akuzonte se administrata po mbushej me militantë partie si dhe po shpërbleheshin, ata që nuk kishin lëpirë ende nga mjalti i taksapaguesve shqiptarë. Në këto kushte, duket sikur po përsëritet historia, pasi zgjedhjet nuk janë larg dhe në administratë do të hyjnë sërish militantët e partisë, të cilët duhen shpërblyer për zellin e shprehur në fushata. Surprizë tjetër, po këtë muaj është edhe lista e re e pagave për punonjësit e administratës publike. Qeveria ka zbardhur edhe tabelën me pagat e reja për çdo kategori. Ajo që bie në sy është rritja e

⁷⁴Njoftimi i nxjerrë në Departamentin e Administratës Publike pësa i përket vendeve vakante të punës.
<http://www.dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta>

⁷⁵Artikull në gazetën Panorama në lidhje me hapjen e 1000 vendeve të punës në Administratën Publike.
<http://www.panorama.com.al/vendimi-qeveria-hap-mbi-1-mije-vende-pune-ne-administraten-publike9/>

pagave për disa kategori në institucionin e Këshillit të Ministrave, ndërsa kanë pësuar ulje page punonjësit e doganave, shkruan Portali Albeu.com⁷⁶.

Drejtori i njësisë do të përfitojë pagë 2a, ndërsa juristët, inspektorët dhe koordinatorët pagë 2b. Më konkretisht paga për këto dy kategori do të jetë 107100 lekë për kategorinë 2 a dhe 89800 lekë për kategorinë 2 b. Të dyja rastet përfitojnë edhe 2 për qind shtesë për vite pune. Ndërsa te doganat kanë pësuar ulje pothuaj të gjithë punonjësit. Nga tabela e pagave rezultojnë se ulja ka ardhur si rezultat i rivlerësimit të kushteve të punës në dogane. Më përpara, kushtet në dogana janë cilësuar si "vështirësi në punë", ndërsa tashmë ky përfitim ka ardhur duke u ulur, pasi kushtet në dogana shihen si favorizuese dhe lehtësuese, krahasuar me ato të mëparshmet. Një tjetër vendim që bie në sy është edhe rritja e pagës për artistët.

Më konkretisht, kryeministri Rama ka vendosur që të rrisë me 3 mijë deri në 5 mijë lekë të gjitha pagat e punonjësve të Teatrit Kombëtar, të Teatrit të Operas dhe Baletit si dhe të Ansambllit Popullor.

⁷⁶Lista e rikonfiguruar e pagave që vjen si pasojë e ndryshimit të njësive vendore.

<http://infoelbasani.al/2016/03/06/sa-te-jene-pagat-e-drejtuesve-dhe-nepunesve-ne-bashkite-e-reja/>,
<http://www.albeu.com/shqiperi/zbardhet-pagat-e-reja-te-administrates-shteterore/143142/>

MINISTRIA E SHTETIT PËR INOACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

Mirilda TILI, BA

1- Në Shqipëri ka vende pune, por jo për ty

Ministria e Shtetit për Inovacion dhe Administratën Publike, ashtu si simotra e vet, Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore, ka një përplasje kompetencash dhe shpesh, për të mos thënë në të gjitha rastet, të dyja ministritë kanë të njëjtin aktivitet dhe të njëjtat fusha mbulimi. Në të tilla kushte vjen natyrshëm edhe sugjerimi që ose të shkrihen me njëra- tjetrën, ose të jenë institucione në varësi.

Për muajin mars vlen të përmendet kërkesa e Ministres së Shtetit për Inovacion dhe Administratën Publike, Milena Harito, për një ndryshim në pagesat e punonjësve të administratës publike. Edhe në këto kushte, kemi të njëjtat kritika si ndaj Ministrisë së Shtetit për Çështjet Vendore. Këto pagesa, të cilat parashihet të kenë një rritje deri në 30 për qind, do të jenë të pranueshme. Ndërsa thirrja për më shumë se 1 mijë vende të lira punë në administratë, madje edhe në nivele drejtuese, duket se është një fushatë për të cilën kritikant nuk do të kursehen. Premtimi kur kjo qeveri erdhi në pushtet ishte për 100 mijë vende pune, megjithatë thirrja për të punësuar 1 mijë vetë tingëllon jo realiste. Përveç kësaj, web faqet ku edhe të interesuarit duhet të aplikojnë, nuk punojnë, po kështu nuk janë të shpallura afatet e dorëzimit të dokumentacioneve, kualifikimet e kërkuara. Për të gjitha këto, lind dyshimi që administratat do të popullohen sërish nga militantë partie, të cilët duhet të shpërblehen për kontributin e dhënë në zgjedhjet e fundit apo për ata që priten të kontribuojnë në favor të fushatës së ardhshme.

Po në këtë muaj, harta e përfolur në këta 3 vite (nga 2013 e këtej), u bë më në fund gati. Shteti ka tashmë një hartë unike dixhitale, në të cilën janë pasqyruar informacionet e 43 shtresave hartografike.⁷⁷

⁷⁷Njoftimi zyrtar në faqen e Ministrisë për Inovacionin dhe Administratën Publike.
<http://www.inovacioni.gov.al/al/newsroom/lajme/preza>

Kjo hartë së bashku me kufijtë e rinj administrativë të përcaktuar në bazë të ndarjes së re territoriale janë prezantuar në një aktivitet të organizuar nga Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Milena Harito dhe Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Bledi Çuçi, me pjesëmarrjen e 61 kryetarëve të bashkive dhe drejtues të institucioneve kryesore në vend.⁷⁸

Sigurisht që edhe për këtë hartë ka një ueb sajt të dedikuar. Por në të po punohet ende, ndaj do të presim e saj variantin final. Në Hartën Unike Dixhitale janë pasqyruar të dhëna për: kufijtë e rinj administrativë sipas ndarjes së re territoriale; imazhe dhe fotografi ajrore të të gjithë territorit të vendit; harta topografike me të dhënat për gjithë relievin e vendit. Në të përfshihen gjithashtu harta e pasurive të paluajtshme, sipas gjendjes së regjistrimit fillestar (2,2 milionë parcela toke); harta e sistemit të adresave (33 mijë km linear rrugë dhe 730 mijë ndërtesa të dixhitalizuara); harta e bizneseve (81 500 biznese); harta e vendndodhjes së institucioneve arsimore; harta e zonave të rrezikut në shërbim të emergjencave civile, hartat gjeologjike dhe e përdorimit të tokës; harta e fondit të kompensimit fizik (25 mijë hektarë); harta e zonave të mbrojtura. I gjithë ky gjeoinformacion ka rolin e burimit kryesor për hartimin e detyrave të projekteve e deri tek menaxhimi i emergjencave civile. Ai është tashmë në dispozicion të publikut pa pagesë në adresën <http://geoportal.asig.gov.al/>.

[ntohet-harta-unike-dixhitale-dhe-kufinjte-e-rinj-administrative](#)

⁷⁸Harta e kufijve administrativo-territorialë përcaktohet me koordinata të sakta gjeografike në formatin GIS. Prezantimi u bë nga ministria Harito. <http://www.noa.al/artikull/prezantohet-harta-unike-dixhitale-dhe-kufinjte-e-rinj-administrative/561883.html>, <http://www.oranews.tv/vendi/harta-unike-dixhitale-cuci-20-e-nesive-vendore-ne-konflikt-per-kufijte/>

MINISTRIA E SHËTETIT PËR MARRËDHËNIET ME PARLAMENTIN

Mirilda TILI, BA

1- Dyst

Edhe në muajin e tretë të vitit, Ministria e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin me shumë zell dhe dashuri ka bërë ASGJË.⁷⁹ Nga ky këndvështrim, edhe pse APPA gjithmonë është shprehur që kjo ministri duhet të mbyllet, madje ka bërë edhe rekomandimin që të kalojë në nivel drejtorie në rast se ka diçka për të bërë, uji nuk është vënë në zjarr nga askush. Nuk ka qoftë dhe një ditë të vetme në muajin mars që, ministrja Ermonela Felaj të ketë deklaruar diçka rreth punës së dikasterit që ajo mbulon. Duke qenë se është një ministri pa portofol dhe rrjedhimisht edhe pa buxhet, të krijohet përshtypja se individët e përfshirë në të janë aty pikërisht për të mos punuar. Po kështu edhe në faqen zyrtare të kryeministrit, përveç profilit të ministres Felaj, nuk ka asnjë informacion tjetër. Ndërsa ueb sajt i ministrit nuk funksionon (!). Pra nuk ka asnjë të dhënë për atë se çfarë bën dhe nuk bën kjo ministri.

Në sugjerimet tona të bëra publike jo vetëm në raportet mujore, por edhe në deklaratat mediatike, jemi shprehur sikurse e vumë në dukje pak më sipër. Tingëllon e çuditshme, absurde? Në kontekstin e zhvillimeve të fundit mendojmë se mendimet tona të bëra publike nuk janë pa bazë. Konkretisht: në sfondin e zhvillimeve të përgjithshme politike që kanë qenë e mbeten në fokusin e monitorimeve tona dhe veçanërisht në sfondin e marrëdhënieve aktuale mazhorancë – opozitë brenda parlamentit, kjo ministre ka pasur rast të luante një rol kyç si dhe të bëhej promotore e zgjidhjeve. Situatat e tensionuara në parlament mund të kishin qenë edhe një mundësi e mirë që ky institucion të tregonte kapacitetet dhe aftësitë e veta. Madje do të mund të provonte se taksat që shkojnë për ta mbajtur atë do të merrnin kuptim. Por edhe këtë muaj nuk e pamë gjë të tillë!

⁷⁹Faqja zyrtare online

<http://www.marredhenietmeparlamentin.gov.al/>

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, E TURIZMIT, E TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

Gerion TRESKA, MSc

1- "Ra" kjo naftë e u pamë

Rënia e çmimit të naftës duket se ka tronditur mjaft indikatorë të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare. Po ky faktor mund të kthehet edhe në një "justifikim perfekt" qeveritar dhe të institucioneve të tjera shtetërore për argumentimin mbi të ardhurat e ulëta, apo nëse deflacioni vjen nga ritmi i lartë ekonomik ose e kundërta.

Tutori FMN, i cili nuk humbet për asnjë moment shikimin nga arkat, financat dhe ekonomia e vendit tonë, në vizitë e tij në mars foli me tone në përgjithësi qetësuese për të justifikuar performancën e qeverisë shqiptare. Duke e vlerësuar situatën aktuale si një inflacion të importuar kryesisht nga rënia e çmimit të naftës në bursat dhe tregjet ndërkombëtare, Banka e Shqipërisë së bashku me FMN-në nuk tentojnë dhe nuk mendojnë ta ndryshojë shifrën e rritjes së ekonomisë që pritet të jetë 3.4%⁸⁰ këtë vit, pavarësisht se inflacioni aktual dhe ajo prirje nuk na bëjnë aspak të sigurt për arritjen e këtij niveli.

Kjo situatë e ekonomisë sonë është një indikator i qartë se si çmimi i naftës mund të ndikojë menjëherë në të ardhurat e qeverisë dhe buxhetit të shtetit⁸¹, ndikim që ndihet drejtpërdrejtë në TVSH, rentën minerare dhe akcizë. Pavarësisht se Banka Qendrore përpiqet të qetësojë opinionin publik duke shpjeguar se është në vëzhgim të situatës, të cilën e ka nën kontroll⁸², qytetarët janë ata

⁸⁰Dizinflacion shpjegimi i ri për situatën aktuale ekonomike.

<http://www.reporter.al/dizinflacion-shpjegimi-i-ri-per-situaten-aktuale-ekonomike/>

⁸¹Takimi I FMN me qeverinë, projeksion për uljen e çmimeve në bursë.

<http://acp.al/news/1905/Takimi-i-FMN-me-qeverine-projeksion-per-uljen-e-cmimeve-ne-burse/>

⁸²Banka e Shqipërisë: Ekonomia nuk është në situatë deflacioniste dhe as nuk rrezikohet prej saj.

të cilët duhet të shlyejnë faturat e politikave fiskale, monetare si dhe të modeleve ekonomike që duken gjithnjë e më të pasigurta dhe zhgënjyese. Situatës aktuale i bashkohet edhe një nga problemet dekurruese si për biznesin shqiptar, por edhe për investitorët e huaj, mosmarrëveshjet ndërmjet institucioneve të administratës publike dhe biznesit⁸³. Ky ka qenë një prioritet në mbledhjen e Këshillit të Investimeve, duke sjellë në vëmendje humbjet në kosto financiare, por edhe jo financiare, të bizneseve dhe institucioneve publike. Në përfundim të mbledhjes u përpiluan disa rekomandime për qeverinë, e cila me këshillë të komunitetit ndërkombëtar, pjesë e Këshillit të Investimeve, jo vetëm që duhet t'i marrë parasysh por edhe t'i verë menjëherë në jetë.

Situata ekonomike në Shqipëri nuk është në një nga momentet e saj më të mira. Importi i të mirave dhe i të këqijave "pa doganë" dhe instrumente lokale, apo edhe një ekonomi e strukturuar sjell në vëmendje vulnerabilitetin e ekonomisë ndaj faktorëve të jashtëm dhe atyre të brendshëm. "Sistemi imunitar" i varfër nuk na lejon dhe nuk do të na lejojë që të identifikojmë faktorët real, që ndikojnë pozitivisht ose jo në ekonomi. Për pasojë, ndërmarrja e politikave në këtë situatë është thjesht një manovrim, që harxhon disa para, por nga ana tjetër nuk prodhon asgjë.

2- SIISKM e INSTAT me të njëjtin "baba"?!

Bazuar në vendimin Nr. 148, datë 24.2.2016 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e kryeministrit, Këshilli i Ministrave vendosi ngritjen e *Sistemit të Integruar të Informacionit dhe Statistikës të Këshillit të Ministrave, SIISKM*, i cili organizohet dhe funksionon me qendër në Kryeministri dhe njësitë përbërëse në çdo ministri të linjës⁸⁴.

<http://acp.al/news/1898/Banka-e-Shqiperise:-Ekonomia-nuk-eshte-ne-situatë-deflacioniste-dhe-as-nuk-rrezikohet-prej-saj/>

⁸³Ministrja Milva Ekonomi mbledh Këshillin e Investimeve

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/ministrja-milva-ekonomi-mbledh-keshillin-e-investimeve>

⁸⁴Vendimi I Këshillit të Ministrave për themelimin e SIISKM

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PD-F-2016/33-2016.pdf

Ky është institucioni më i ri i qeverisë shqiptare, për të cilën me sa duket INSTAT nuk i arrin mjaftueshëm "standardet qeveritare" në aktivitetin që kryen.

SIISKM-ja ka për qëllim administrimin dhe menaxhimin e fluksit të informacionit në funksion të vendimmarrjeve politike e strategjike të Këshillit të Ministrave, kryeministrit e të ministrave, në funksion të komunikimit e bashkëveprimit ndërinstitucional si dhe të mirëmbajtjes së të dhënave thelbësore statistikore, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Po në të njëjtën kohë INSTAT, ka të drejtë të kërkojë nga ministritë dhe institucionet qendrore dhe vendore shfrytëzimin e të dhënave administrative dhe statistikore, përveç të drejtave të tjera, të specifikuara në program⁸⁵. Në të njëjtën kohë, raportet e SIISKM-së janë dokumente përfundimtare dhe referencë e detyrueshme zyrtare, si në komunikimin ndërinstitucional ashtu dhe në komunikimin publik. Në çdo komunikim ndërinstitucional, ndërmjet Kryeministrit e ministrive apo strukturave të tjera të varësisë si dhe ndërmjet ministrive kryhet nëpërmjet strukturave të SIISKM-së.

Por çfarë i mungon SIISKM-së, që patjetër duhet t'i ketë shpëtuar pa dashje themeluesit të saj, është se, në ndryshim nga INSTAT, po me të njëjtin baba themelues - *përgjegjës për të siguruar se statistikat zyrtare janë bërë të disponueshme në baza paanësie për të gjithë përdoruesit e interesuar* - një element i tillë paanshmërie duket se mungon, çka mund të çojë në aludime spekulative të tipit "qeveria po e përdor si do vetë SIISKM-në". Po ashtu si INSTAT-i, SIISKM është në varësi të kryeministrit pasi protokollat e mbledhjes, përpunimi, analiza dhe publikimi i informacionit, si dhe procedurat standarde të punës, rregullohen me akte të veçanta, që miratohen nga kryeministri për Zyra Operacionale të Situatës dhe nga ministrat përkatës për Zyrat e Informacionit dhe Menaxhimit të Emergjencave Civile dhe Krizave.

Si përfundim, ndryshimet mes INSTAT dhe SIISKM janë pothuajse të "papërfillshme", çka i kthen këto institucione në simotra, të

cilat mund t'i shërbejnë të njëjtit qëllim: ofrimin e të dhënave statistikore për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, qofshin këto reale ose jo, ose, mos e dhëntë Zoti, që të jenë kontradiktore me njëra-tjetrën. E nëse do të duam të shpjegojmë një efekt të një politike ose reformë dhe përdorim shifra të cilat përputhen nga këto dy institucione, atëherë është më se e legjitimuar heqja e një vize, e cila kalon në këto dy pika, duke provuar kështu pikëpamjen me të cilën qeveria do të legjitimojë veprimet e saj si gjithmonë të drejta përpara të gjithëve.

⁸⁵Statuti i INSTAT

<http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/legjislacioni.aspx>

MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

Mimi BARUSHI, MSc

1- Një reformë në nevojë të reformimit

Reforma administrativo-territoriale e ndryshoi hartën e Shqipërisë duke reduktuar numrin e njësive lokale nga 400 në 61 të tilla. Ndarja e re administrative u ndërmor duke synuar të jetë gjithëpërfshirëse dhe tërësore, për të fuqizuar njësitë e qeverisjes vendore, duke rritur kapacitetin e tyre dhe ulur kostot administrative, si dhe duke përmirësuar eficiencën e menaxhimit të burimeve njerëzore e financiare.⁸⁶ Diskutimet që nisën në vitin 2015 mbi ndarjen e re administrative vazhdojnë ende në këto ditë. Shoqata Shqiptare e Bashkive, që përfaqëson 15 bashkitë e drejtuara nga partitë opozitare dhe një e minoritetit grek, shpreh vazhdimisht shqetësimin për mënyrën sesi po realizohet reforma territoriale, apo për ndarjen e kufijve dhe përfaqësimin e komuniteteve të ndryshme.

Në të njëjtën kohë, misioni i Këshillit të Europës, i drejtuar nga Jos Wiene, pas mbledhjes së informacionit mbi reformën e re administrative dhe impaktin e saj në Shqipëri, raporton se reforma është ende konfuze për kryetarët e rinj të bashkive, duke vënë në dukje çorientimin në lidhje me kompetencat dhe strukturat përkatëse. KE thekson mungesën e fondeve nga ana e qeverisë për bashkitë e reja, si dhe shqetësimin për mënyrën e dhënies së fondeve, pasi "Fondi i Zhvillimit të Rajoneve" menaxhohet nga qeveria qendrore. *Qeveria ofroi 88 milionë euro në vitin 2014 dhe 87 milionë euro në 2015 për zhvillimin rajonal dhe thuajse gjysma e kësaj sasive u përdor gjithashtu për rilindjen urbane të qyteteve të vogla. Pas raundit të parë të aplikimeve në vitin 2016, qeveria ka ofruar 28 milionë euro për zhvillimin rajonal.*⁸⁷ Në tërësi reforma konsiderohet nga KE si e ngadaltë dhe e vështirë për t'u realizuar.

⁸⁶ Vizioni për Reformën Administrative Territoriale. -

<http://www.reformaterritoriale.al/kryesore/harta-me-61-bashki>

⁸⁷ Përpjekja për rilindjen e qyteteve të voglanë Shqipëri ngjall debate - <http://pushtetivendor.reporter.al/perpjekja-per-rilindjen-e-qyteteve-te-vogla-ne-shqiperi-ngjall-debate/>

2 - Është rilindja estetike një element i mjaftueshëm për ripopullimin e qyteteve dhe fshatrave tona?

Në programin e qeverisë 2013 - 2017 thuhet: Do të ndërmerret një program i thellë reformues për rigjenerimin urban dhe zhvillimin cilësor të tokës përmes projektsh-pilot për qendrat urbane, por edhe përmes mbështetjes së projekteve dhe agjendave të zhvillimit të lagjeve, mbi baza konkurruese. Do të mbështetim pushtetin vendor, që të marrë rolin udhëheqës në zhvillimin e tokës, duke mbrojtur zonat natyrore, historike dhe bujqësore, për të garantuar partneritet publik e privat në financimin e strukturave dhe shërbimeve, duke administruar shpërndarjen e së drejtës së zhvillimit. Ndërkohë, diskutimi mbi rilindjen e qyteteve, si pjesë e diskutimit të reformës administrative-territoriale, është kthyer në temë kryesore tashmë.

Qeveria akuzohet nga Shoqata e Bashkive⁸⁸ për favorizim të bashkive që qeverisen nga Partia Socialiste në financim dhe mbështetje, si dhe për keqmenaxhim të fondeve në rregullimin sipërfaqësor të infrastrukturës e fasadave të ndërtesave. Shërbimet nuk janë kanalizuar aty ku nevojat është më e madhe, si rrugët, urat apo linjat hekurudhore, që mund të lehtësonin jetën e popullsisë vendase dhe zvogëlonin migrimin e tyre. Ekspertët, arkitektët dhe urbanistët janë të shqetësuar për transparencën dhe mënyrën se si operohet në përgatitjen e planeve urbanistike dhe arkitekturore të qyteteve. Do të sugjerohet që në vend që të hapeshin tendera dhe të përzgjidhej studioja sipas mënyrës të deritanishme, (në raportin e janar-shkurt kemi diskutuar për këtë), të merrej kohë përgatitore më parë, të kishte diskutime publike mbi nevojat e komunitetit, të prezantoheshin mundësitë nga studiot e ndryshme dhe të zhvillohej një debat i hapur dhe më pas të bëhej përzgjedhja dhe zbatimi.

⁸⁸ Bashkiakët e djathtë: Qeveria po na diskriminon me projektet. - <http://www.gazeta-shqip.com/lajme/2016/03/13/bashkiaket-e-djathte-qeveria-po-na-diskriminon-me-projektet/>